



KOMPAS është emri zyrtar i projektit të financuar nga Qeveria Hollandeze në Shqipëri të titulluar 'Komunitet Pushtet Administratë Së Bashku' dhe i realizuar në Shqipëri në periudhën Maj 2000-Prill 2004.

Libri "Model i Statutit të Bashkisë" është përgatitur për Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, si pjesë e programit KOMPAS për mbështetjen dhe zhvillimin e produkteve për ShBSh-në. Ky dokument është skicuar për të qënë një ndihmë ndaj kësaj shoqate në përpjekjet e saj për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve të Bashkive të Shqipërisë.

Ky dokument është një përpjekje e përbashkët e VNG-I (Agjensia Ndërkombëtare e Shoqatës së Bashkive të Hollandës dhe FLAG (Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje).



VNG International
Tel: ++31 70 3738386
Fax: ++31 70 3738660



Fondacioni për Autonomi
Vendore dhe Qeverisje
Rruga Brigada 8,
Tiranë, Shqipëri
P.O.Box: 8291
Tel: ++ 355 4 239611



Shoqata e Bashkive të
Shqipërisë (ShBSh)
Rr. 'Ismail Qemali'
Nr.27, Kati V,
P.O. Box 244
Tiranë, Shqipëri
Tel: ++ 355 4 257603

Ky model i statuti është përgatitur nga
ekspertë të FLAG

Artan Rroji,
ekspert i qeverisjes vendore

Arben Kashahu,
ekspert ligjor

Për kopje të këtij botimi ju lutem kontaktoni

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Tel/Fax: 00355 4 257 603

E-mail aam@albmail.com

Apo vizitoni faqen e internetit të shoqatës

www.aam-al.org

Kopertina: Eda Ilirjani

Botuar në Tiranë- Shqipëri në Prill 2004

Permbajtja

KAPITULLI I	
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	13
KAPITULLI II	
TË DREJTAT, FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT THEMELORE TË BASHKISË	29
KAPITULLI III	
PUSHTETI LIGJVENES.....	40
<i>KREU 1 Autoriteti Ligjvënës.....</i>	<i>41</i>
<i>KREU 2 Këshilli i Bashkisë.....</i>	<i>51</i>
<i>KREU 3 Mledhjet e Këshillit të Bashkisë</i>	<i>60</i>
KAPITULLI IV	
QYTETARËT.....	82
KAPITULLI V	
PUSHTETI EKZEKUTIV	85
KAPITULLI VI	
ADMINISTRATA E BASHKISË	95
<i>KREU 1 Organizimi i Administratës</i>	<i>96</i>
<i>KREU 2 Përbërja dhe Funkcionet Bazë të Njësive të Larta Organizative</i>	<i>98</i>
KAPITULLI VII	
ÇESHTJET FINANCIARE DHE TE BUXHETIT	107
KAPITULLI VIII	
SISTEMI I SHËRBIMIT CIVIL NË BASHKI.....	114
KAPITULLI IX	
AGJENSITË NË VARËSI TË BASHKISË.....	122
<i>KREU 1 Institucionet në Varësi të Bashkisë</i>	<i>123</i>

KREU 2 Ndërmarrjet në Varësi të Bashkisë 126

KAPITULLI X

KUSHTET PËR KONTRAKTIM 128

KAPITULLI XI

ÇESHTJE TE TJERA..... 131

KAPITULLI XII

DISPOZITA KALIMTARE..... 137

Shtojca 1. 143

Shtojca të Tjera..... 144

HYRJE

Teoritë mbi qeverisjen demokratike tradicionalisht kanë besuar në një model organizimi në të cilin zyrtarët veprojnë në mënyrë të paanëshme, pranojnë qartësisht të dhënit llogari dhe të qenurit nën kontroll dhe zbatojnë detyrat e tyre të përditshme bazuar në rregulla, procedura dhe diskrecion të përcaktuar.

Decentralizimi dhe zhvillimi modern i sistemeve të menaxhimit të qeverive vendore po ballafaqon bashkitë Shqiptare me praktika dhe eksperiencë të avancuara të ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve të tyre si organizata të cilat duhet të jenë të hapura për publikun dhe të ofrojnë

shërbime cilësore duke shfrytëzuar burime njerëzore dhe financiare të kufizuara.

Bashkitë Shqiptare operojnë tashmë në një ambient të hapur dhe konkurses si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Bashkitë e vendeve perëndimore fqinje kanë tashmë një histori të gjatë të zhvillimit dhe konsolidimit të tyre, prandaj përpjekjet për rritjen e qëndrueshme të kapaciteteve organizative të bashkive Shqiptare po bëhen gjithnjë e më shumë një sfidë e ditës.

Bashkitë Shqiptare janë në një fazë shtimi të funksioneve, ushtrimi me sukses i të cilave kërkon një organizatë të konsoliduar, të mirëorganizuar dhe mirëmenaxhuar, në mënyrë që t'i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave dhe nevojave të komunitetit për shërbime, si dhe të përballojë dinamikën e zhvillimeve dhe shtimin e fushave në të cilat qeveria vendore po luan rol primar apo koordinues.

Suksesi i qeverisjes vendore varet shumë nga cilësia e organizatës. Këshillat bashkiakë dhe kryetarët e bashkive kanë nevojë për një organizatë e cila të funksionojë në mënyrë të zhdërvjellët, të koordinuar, profesionale dhe ku çdo segment i organizatës të jetë plotësues i veprimeve

për zbatimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve.

Dokumenti që do të prezantohet në brendësi të këtij botimi është një model statuti bashkiak. Ai përbën referencë për bashkitë Shqiptare që dëshirojnë të kenë një organizatë të zhvilluar mirë, ku nivelet vendimmarrëse, ato të kontrollit, menaxhuese dhe zbatuese të jenë shtresuar qartë dhe pa mbivendosje, ku përgjegjësitë dhe funksionet të jenë të ndara, dhe ku çdo segment i organizatës të ketë të qartë hapësirën e ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me segmentet e tjera.

Rëndësia e statutit lind nga nevoja e bashkisë për të patur një bazë rregullash që garanton dhe lehtëson vendim-marrjen e këshillit bashkiak, marrëdhëniet e këshillit me kryetarin e bashkisë, hierarkinë e administratës bashkiake si dhe funksionet dhe parimet kryesore mbi të cilat ngrihet dhe organizohet puna e administratës bashkiake.

Ky model statut ka si qëllim që të krijojë një model rregullash bazë që të shërbejë si material referues për këshillat bashkiakë, dhe kryetarët e bashkive në përpjekjet e tyre për të krijuar dhe rregulluar marrëdhënie të qarta e të qëndrueshme ndërveprimi brënda

dhe mes njërive të organizatës, si dhe ndërmjet bashkisë dhe organizatave të tjera me të cilat bashkia bashkëpunon. Përshtatja e këtij statuti në kushtet e bashkive të ndryshme do të bëhet nga vetë bashkitë dhe miratimi i tij në këshillin bashkiak do të pajisë bashkinë me një dokument që do të rregullojë në të ardhmen veprimtarinë e organizatës bashkiake.

Ky dokument do t'i shërbejë bashkive të shqipërisë jo vetëm në realizimin e përpjekjeve të tyre për të përmbushur prerogativat ligjore por edhe për të siguruar rregulla të qendrueshme, demokratike dhe stimuluese mbi të cilat do të bazohen marrëdhëniet e përditshme të punës.

Është fakt që tradita e vet-qeverisjes vendore në Shqipëri është nuk ka një histori të gjatë dhe për rrjedhojë mungon një doktrinë mbi të cilën mund të bazohemi dhe orientohemi për hartimin e dokumentave të tilla si statuti i bashkisë dhe kjo për arsye historike që nuk janë objekt analize i këtij botimi. Megjithatë spikat fakti që egzistojnë statute bashkiake si ai i Shkodrës (Scutari) që daton në vitin 1469. Natyra e statutit të bashkisë së asaj kohe ishte pak a shumë kushtetuta e qytetit, pra ligji më i lartë që rregullonte mbarë marrëdhëniet shoqërore të kohës.

Statuti i Bashkisë

Miraturar nga

Këshilli i Bashkisë

më datë _____

Miratimi i këtij Statuti bazohet në Ligjin nr.
8652 datë

31.07.2000 “Për Organizimin dhe
Funksionimin e Qeverisjes

Vendore”, neni 32 pika a.

K A P I T U L L I I

D I S P O Z I T A T Ë P Ë R G J I T H S H M E

NENI 1

STATUTI

Ky Statut dhe të gjitha shtojcat përbëjnë Statutin e Bashkisë së_____.

NENI 2

QËLLIMI I STATUTIT.

Qëllimi i Statutit është të:

- Të krijojë një kornizë rregullatore për ushtrimin e funksioneve të Bashkisë në përputhje me ligjin dhe vullnetin e komunitetit.
- Të sanksionojë marrëdhënjet në mes organeve dhe nivele qeverisëse të Bashkisë.
- Mundësojë Këshillin e Bashkisë të udhëheqë komunitetin e Bashkisë në partneritet me qytetarët, bizneset dhe organizatat e tjera.
- Mbështesë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset e vendim-marrjes vendore.

- Ndhimjohë këshilltarët të përfaqësojnë zgjedhësit e tyre në mënyrë sa më efektive;
- Mundësojë marrjen e vendimeve në mënyrë efektive dhe efçente;
- Krijohë një mjet të fuqishëm dhe efektiv për t'i mbajtuar vendimarrësit në llogari-dhënie për vendimet që marrin;
- Sigurojë se ato që janë përgjegjëse për marrjen e vendimeve janë lehtësisht të indentifikueshëm nga qytetarët dhe që ato të paraqesin arsyet e marrjes së vendimeve.

Të sigurojë mundësitë për përmirësimin e ofrimit të shërbimit ndaj komunitetit.

NENI 3

PËRSHKRIMI I TERMAVE.

Në kuptimin e këtij Statuti;

Administratë e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë, nëpunësit politikë, nëpunësit civil dhe nëpunësit jo civil të qeverisë bashkiake dhe të organizmave në varësi të saj, me përjashtim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Agjensi: Çdo njësi organizative apo institucion në varësi të Bashkisë.

Akt: Çdo vendim, urdhër, urdhëresë, rezolutë, kontratë apo çdo rregullim apo veprim tjetër që ka efektin e të sipërpërmendurave, i shqyrtua dhe miratuar nëpërmjet procedurave, normave, standarteve, kritereve të miratuara nga ligji, Statuti i Bashkisë dhe rregullorja e Këshillit Bashkiak

Aplikant: Një person i cili ka skeduar pranë Departamentit të Personelit një aplikim në kohën e duhur për një pozicion pune në Bashki.

Autoriteti emërues: Nënkupton një person apo bordin e Bashkisë apo një organ të autorizuar nga Statuti i Bashkisë për të kryer emërimet në pozicionet e ofrimit të shërbimeve që siguron Bashkia.

Autoriteti Punëdhënës: Është Kryetari i Bashkisë, të cilit i është deleguar autoriteti, në bazë të ligjit nr.8652 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, për të bërë emërimet dhe shkarkime në administratën e Bashkisë.

Bashkia: Bashkia _____

Çështje: Mocion, projekt-akt, peticion, rezolutë, raport i prezantuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Delegim: Transferimi, me anë të një dokumenti të firmosur ku specifikohen kushtet, i një kompetence nga deleguesi i një rangu më të lartë tek i deleguari i një rangu më të ultët për ta ekzekutuar dhe ku përgjegjësia për ekzekutimin e asaj kompetence ngelet tek i deleguari.

Emërim: Caktimi nga autoriteti i duhur i një personi që do të jetë i punësuar në një pozicion të caktuar në administratën e Bashkisë.

Funksion: Eshtë fusha e veprimtarisë për të cilën është përgjegjës një organ i caktuar.

Funksione të deleguara: Janë funksione të pushtetit qendror ose të institucioneve të tjera qendrore që me ligj ose me marrëveshje caktohen të realizohen nga njësitë e qeverisjes vendore në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga pushteti qendror dhe institucione të tjera qendrore.

Funksione të përbashkëta: Janë funksione për të cilat njësitë e qeverisjes vendore ka pjesën e saj të përgjegjësisë së

dallueshme nga pjesa e përgjegjësive së dhënë pushtetit qendror, si dhe që bashkëshoqërohen përpjesëtimisht me kompetenca, të cilat i ushtron në mënyrë autonome.

Funksione të veta: Janë funksionet e dhëna me ligj njësisë së qeverisjes vendore, për të cilat ajo është përgjegjëse për realizimin, si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për realizimin e tyre, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuarra përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullator.

Grup Politik: Grup politik Këshilltarësh Bashkiak të një forcë politike elektorale ose/apo Këshilltarësh të pavarur.

Informacion konfidencial: Informacion i klasifikuar me ligj si jo publik (psh. informacion për personat që marrin ndihmë ekonomike, rekorde kriminale, rekorde mjeksore, të shëndetit mendor etj).

Kandidat: Një person, aplikimi i të cilit për të zënë një pozicion në administratën e

Bashkisë, është pranuar për t'u marrë në provim.

Këshilli i Bashkisë: Këshilli i Bashkisë

Këshillimet me Bashkësinë: Përfshijnë takime të hapura me banorët, takime me specialistët, me institucionet dhe organizatat jo-qeveritare të interesuara për çështjen në konsiderim, apo nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

Këshilltar: Këshilltar/e i/e Këshillit Bashkiak i/e mandatuar.

Kompetencë: Eshtë autoriteti dhënë me ligj një organi për kryerjen e një funksioni.

Kompetenca të veta: Janë autoritetet ekskluzive që u janë dhënë me ligj njësisive të qeverisjes vendore për realizimin e funksioneve të veta.

Kompetencë administrative: Eshtë kompetenca për menaxhimin e strukturave dhe personelit (ngritjen, përmirësimin, shkrirjen e strukturave, si dhe emërimin, shkarkimin, transferimin, kualifikimin, përcaktimin e pagave dhe

shpërblimeve të personelit) në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kompetencë e deleguar: Eshtë kompetenca e pushtetit qendror që, me ligj ose me marrëveshje, i është dhënë njësisë së qeverisjes vendore.

Kompetencë investimi: Eshtë kompetenca për planifikimin, shpërndarjen dhe realizimin e investimeve.

Kompetencë rregullatore: Eshtë kompetenca për krijimin dhe vendosjen e rregullave (dhënie licencash, caktime oraresh, vendosje gjobash ose në përgjithësi dhënie të drejtash ose krijim detyrimesh), duke respektuar standardet dhe legjislacionin në fuqi.

Kompetencë Shërbimi: Eshtë kompetenca për planifikimin, shpërndarjen dhe realizimin e mirëmbajtjes së objekteve dhe shërbimeve ndihmëse.

Komision i Përhershëm: Komision me Këshilltarë Bashkiak i cili krijohet nga Këshilli në funksion të diskutimit, debatimit dhe rekomandimit të një drejtimi për veprim që duhet të marrë Këshilli për të marrë vendime në zbatim

të ushtrimit të kompetencave të dhëna me ligj, i cili funksionon gjatë gjithë mandatit të Këshillit.

Komision i Përkohshëm: Komision me Këshilltarë Bashkiak i cili krijohet nga Këshilli për një qëllim të veçantë në funksion të diskutimit, debatimit dhe rekomandimit të drejtimit për veprimet që duhet të marrë Këshilli për të marrë vendime në zbatim të ushtrimit të kompetencave të dhëna me ligj, i cili funksionon për një periudhë të kufizuar deri në realizimin e qëllimit të veçantë për të cilin është ngritur.

Kontratë: Një marrëveshje me terma specifike e bërë në mes Bashkisë dhe një personi fizikë ose juridik ku shprehet angazhimi për furnizime me materiale dhe/apo pajisje, shërbime dhe/apo ndërtime në këmbim të një përfitimi me vlerë.

Kryesia: Kryetari dhe N/kryetari i Këshillit Bashkiak.

Kryesuesi: Kryetari, Z/Kryetari apo secili Këshilltar, në mungesë të dy të parëve, i cili kryeson një Mbledhje Zyrtare të Këshillit Bashkisë _____.

Kryetari i Bashkisë: Kryetari/ja i/e
Bashkisë_____.

Kryetar i Këshillit: Kryetari/ja i/e Këshillit
Bashkisë_____.

Kuorum: Shumica e të gjithë Këshilltarëve,
duke përjashtuar vendet e mundshme
bosh në Këshill në momentin e llogaritjes
së Kuoromit, shumicë e cila e bën të
vlefshme për procedim një mbledhje
zyrtare të Këshillit.

Kuorumi i Parave: Tre të pestat (3/5) e
numrit të përgjithshëm të Këshilltarëve
të cilët marrin vendim për miratimin e
një shpenzimi, buxheti apo zëri të
buxhetit Bashkiak.

Llogaridhënje: Sistemi i planifikimit,
monitorimit dhe reportimit me anë të të
cilit puna e departamenteve specifikohet
paraprakisht dhe Bashkia dhe drejtuesit
ekzekutivë japin llogari për shërbimet që
ofrojnë.

Mandatim: Transferimi i një kompetence
me anë të një dokumenti të firmosur, ku
specifikohen kushtet, i një kompetence
nga mandatuesi një rangu më të lartë tek
i mandatuari një rangu më të lartë për ta
ekzekutuar dhe përgjegjësia për

ekzekutimin e asaj kompetence ngelet tek mandatuesi.

Mbledhja organizative: Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak mbas zgjedhjeve vendore, ku bëhet mandatimi i Këshilltarëve të sapozgjedhur dhe zgjidhet Kryetari, Z/Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe Komisionet e Përhershme të Këshillit.

Mbledhje e Mbyllur: Është një mbledhje ku nuk lejohet pjesëmarrja e publikut dhe e jo-Këshilltarëve.

Mbledhje e Rregullt: Është një mbledhje e Këshillit Bashkiak e cila mbahet në datën, orën dhe vendin e caktuar nga Këshilli Bashkiak në mënyrë të përhershme sipas kësaj rregulloreje.

Mbledhje e Vlefshme: Është mbledhja e Këshillit Bashkiak gjatë procedimeve të së cilës është i pranishëm kuroumi.

Mbledhje Emergjence: Është një mbledhje e Këshillit Bashkiak e cila mbahet në rrethana të papritura dhe emergjence gjatë procedimeve të së cilës shqyrtohen dhe diskutohen çështje emergjente për të cilat nuk mund të pritët për 48 orë dhe ku ndërmerren veprime të menjëhershme.

Mbledhje Vazhduese: Është çdo mbledhje e rregullt, jashtë radhe, emergjence dhe mbledhje e mbyllur e Këshillit Bashkiak për të cilën data, ora dhe vendi i mbajtjes së saj caktohet në mbledhjen paraprake dhe ku konsiderohen çështje të rendit të ditës të po kësaj mbledhjeje paraprake.

Mbledhje Zyrtare: Është çdo Mbledhje e Rregullt, Mbledhje e Jashtë Radhe, Mbledhje Emergjence, Mbledhje Vazhduese qoftë kjo e Hapur apo e Mbyllur e cila zhvillohet me pjesëmarrjen e Kuorumit, dhe për të cilën data, ora, vendi dhe rendi i ditës i janë njoftuar Këshilltarëve dhe publikut sipas procedurave të ligjit, Statutit të Bashkisë dhe kësaj rregulloreje.

Mbledhje: Është çdo grumbullim apo komunikim i njëkohshëm, në një sallë apo nëpërmjet mjeteve elektronike, të Këshilltarëve të mandatuar të Këshillit Bashkiak, e thirrur sipas Ligjit, Statutit të Bashkisë dhe Rregullores së Këshillit, ku Këshilltarët diskutojnë vetëm për çështje publike dhe ndërmarrin veprime për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave që i janë dhënë Këshillit me ligjin nr.8652 neni 32.

Mbledhje Jashtë Radhe: Është një mbledhje e Këshillit Bashkiak, përveç mbledhjes emergjente dhe vazhduese, e cila mbahen në një kohë dhe vend ndryshe nga ato të mbledhjes së rregullt të Këshillit.

Njësi Organizative: Cilado njësi që ka funksione të ndara dhe të pavarura dhe që njihen si të tilla nga departamenti i personelit të Bashkisë sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë.

Pozicion: Një grup detyrash dhe përgjegjësish të paracaktuara nga një autoritet emërues, që kërkojnë shërbimet e një personi në një pozicion qoftë ky me kohë të plotë apo kohë të pjesshme, në një njësi organizative të dhënë apo punësim të dhënë në shërbimin civil.

Prezantim: Prezantim zyrtar, i plotë dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj, Statutin e Bashkisë dhe rregulloren e Këshillit i një mocioni apo projekt-akti i bërë para Këshillit të Bashkisë.

Proçesverbali i Mbledhjes: Proçesverbali i Mbledhjes Zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Pushtet qendror: Eshtë Këshilli i Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shtetit.

Riorganizim: Eshtë ndryshimi në ndarjen administrative-territoriale.

Sekretari: Sekretari/ja i/e Këshillit Bashkiak.

Shpallje e Aktit: Bërja publike e një akti duke e botuar në shtypin periodik bashkiak apo vendor, duke vendosur në këndet e njoftimit të miratuara nga Këshilli për shpallje të akteve të tij dhe vendndodhja e të cilëve është publikisht e ditur, apo duke e bërë të njohur nëpërmjet radios dhe televizionit vendor.

Shumica absolute: Shumica e numrit të përgjithshëm të të gjithë Këshilltarëve Bashkiak / Anëtarëve, pra 50% +1.

Subjekt i kompetencave të

përbashkëta: Eshtë një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të qeverisjes vendore ose mes njësisive të qeverisjes vendore dhe institucioneveqendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët.

Subsidiaritet: Eshtë parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë shtetasve.

Zgjedhësit: Zgjedhësit e Bashkisë _____ të rregjistruar në rregjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit ë cilëve ju njihet e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur sipas Ligjit nr. 8609 dt. 08. 05. 2000. "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Z/Kryetar i Bashkisë: Z/Kryerari/ja i/e Bashkisë _____.

Z/Kryetar i Këshillit: Z/Kryerari/ja i/e Këshillit të Bashkisë _____.

NENI 4

INTERPRETIMI DHE RISHIKIMI I STATUTIT

Aty ku Statuti i lejon Këshillit të zgjedhë midis disa alternativave, Këshilli do të zgjedhë gjithmonë një alternativë për të cilën ai mendon se është më afër interesave të bashkësisë _____ dhe qëllimit të Statutit.

Këshilli do të monitorojë, vlerësojë dhe interpretojë zbatimin e Statutit.

NENI 5

QËLLIMI I BASHKISË

Qëllimi i Bashkisë është t'i sigurojë banorëve:

njohjen e egzistencës së identiteve dhe vlerave të ndryshme të komunitetit;

respektimin e të drejtave të përcaktuara nga ligji;

mundësinë për komunitetet të bëjnë përzgjedhjen midis shërbimeve bazë publike dhe funksioneve qeverisëse;

ushtrim efektiv të funksioneve, detyrave dhe autoritetit të organeve të bashkisë;

menaxhim dhe alokim të përgjegjshëm të burimeve finaciare, dhe

nxitjen e një pjesëmarrjeje efektive të banorëve në qeverisje.

K A P I T U L L I I I

T Ë D R E J T A T , F U N K S I O N E T D H E K O M P E T E N C A T T H E M E L O R E T Ë B A S H K I S Ë

NENI 6

EMRI DHE KUFIJTË E BASHKISË

Autoriteti bashkiak, aktualisht i njohur si Bashkia _____, është një unitet administrativo-territorial, me emrin “Bashkia _____”, dhe me këtë emër do të ketë vazhdimësi të pandërprerë.

Bashkia _____ shtrin juridiksionin e saj brenda të gjithë territorit me kufij të njohur nga ligji nr. __ „ per ndarjen administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë. *Në aneksin _____ të këtij statuti është paraqitur harta administrativo-territoriale e Bashkisë _____.*

Kufijtë e Bashkisë janë publikë dhe informacioni mbi to së bashku me hartën përkatëse duhet t'i vihet në dispozicion qytetarëve të interesuar me kërkesën e këtyre të fundit.

NENI 7

Bashkia ka të gjitha të drejtat, funksionet dhe kompetencat e shprehura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 108, 109, 111, 112,113, në Kartën Evropiane për Vetqeverisje Vendore, në

Ligjin Organik nr. 8652 datë 31.07.2000 si dhe në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

NENI 8

TË DREJTAT

Bashkia gëzon të drejtën e:

- Qeverisjes.
- Mbledhjes së të ardhurave
- Bërjes së shpenzimeve,
- Kryerjes së veprimtarive ekonomike,
- Bashkëpunimit
- Personit juridik.

- Pronësisë. Ajo mund të blejë, të përfitojë, të mbajë dhe të gëzojë pasuri të tundshme dhe të patundhme brenda dhe jashtë kufijve të vet; mund të shesë, të tjetërsojë, të lërë peng dhe të disponojë këto pasuri për të mirën e e përbashkët të publikut që përfaqëson; mund të pranojë trashëgimi, pajisje, dhurata dhe donacione të çdo lloji brenda dhe jashtë Bashkisë për përdorimin dhe përfitimin e vet dhe të publikut që përfaqëson, apo në mirëbesim për qëllime bamirësie apo

qëllime të tjera publike, dhe të kryejë gjithçka të nevojshme për të arritur synimet në lidhje me këto dhurata, trashëgimi, pajisje dhe donacione, me kompetencën për të administruar, shitur, lënë me qera apo edhe të disponojë për sa më sipër. Bashkia nuk pranon asnjë dhuratë që konsiston në armatime, pajisje ushtarake, pa miratimin me urdhëresë nga organi kompetent. Ndërtesat, trojet dhe pronat e tjera publike, të gjitha të drejtat e pronësisë, paratë, të ardhurat dhe hyrjet që i përkasin apo që lidhen me Bashkinë, shpallen pronë e kësaj Bashkie dhe ajo do të vazhdojë të ketë, të mbajë dhe të gëzojë po këto të drejta ndaj gjithë detyrimeve, borxheve, përgjegjësisive, kuotizacioneve dhe taksave të bashkisë ekzistuese.

- Dhënjes së titujve të nderit dhe të stimujve,
- Vendosjes së emertimeve territoriale, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e saj, sipas kriterëve të percaktuara me ligj dhe ky statut.
- Ngritjes së padi së dhe mbrojtjes në të gjitha çështjet dhe procedimet,

- Zotërimit dhe përdorimit të vulës të saj të cilën mund ta ndryshojë sipas dëshirës;

NENI 9

Bashkia është person juridik.

NENI 10

Bashkia është organ qeverisës me vazhdimësi.

NENI 11

SIMBOLET E BASHKISË

Bashkia ka emblemën dhe flamurin e saj.

NENI 12

EMBLEMA E BASHKISË

Emblema përbëhet nga këto elementë:
(përshkruhet me fjalë)

NENI 13

FLAMURI I BASHKISË

Flamuri përbëhet nga këto elementë:
(përshkruhet me fjalë)

NENI 14

LLOGARIA BANKARE E BASHKISË

Bashkia ka llogarinë e saj bankare. Numri i llogarisë është_____.

NENI 15

TERRITORI I BASHKISË

Territori I Bashkisë është_____ km m2 dhe shtrihet_____.

Bashkia kufizohet: V__, J__, P__, L__.

NENI 16

NDARJA TERRITORIALE E BASHKISË

Bashkia _____ ndahet në ___ njësi administrative. Ato emërtohen si më poshtë :

Në Aneksin nr_____ jepet harta e njësive administrative të bashkisë.

NENI 17

QEVERISJA E BASHKISË

Bashkia Qeveriset nga organi i Këshillit të Bashkisë dhe ai i Kryetarit të Bashkisë.

- a. Këshilli i Bashkisë i është organi përfaqësues dhe vendim marrës;
- b. Kryetari i Bashkisë i është organi këshillues politikash, ekzekutiv dhe administrative dhe ndihmohet nga Nëpunësit të cilët përbëjnë administratën e qeverisë bashkiake.

NENI 18

MARRJA E NISMËS

Organet e Bashkisë mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor për çdo çështje që nuk u ndalohe me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.

NENI 19

PARIMET E PUNËS SË ORGANEVE DHE ADMINISTRATËS SË BASHKISË.

Organet dhe administrata e Bashkisë e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe në përputhje dhe duke u mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Parimi i ligjshmërisë;
- Parimi i subsidiaritetit;

- Parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave të personave privatë;
- Parimi i barazisë dhe proporcionalitetit;
- Parimi i drejtësisë dhe panësisë;
- Parimi i bashkëpunimit të administratës me personat privatë;
- Parimi i përgjegjshmërisë;
- Parimi i marrjes së vendimeve të hapura;
- Parimi i eficiencës dhe i deburokratizimit;
- Parimi i kontrollit të brendshëm dhe atij gjygjësor;
- Parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe kofidencialitetit;
- Parimi i mosdiskriminimit;
- E drejta për t'u informuar;

Marrëdhëniet e Bashkisë me bashkitë e tjera si dhe me organet e pushtetit qendror bazohen në parimin e subsidiaritetit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

NENI 20

PARIMET E VENDIM-MARRJES

Të gjitha vendimet që merr Këshilli Bashkiak do të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:

- a. Proporcionalitetit – të gjitha veprimet duhet të ndërrmerren në proporcion me rezultatet e dëshirueshme.
- b. Konsultimit – do të jepet konsulenca e duhur dhe profesionale nga ana e zyrtarëve të bashkisë.
- c. Të Drejtat e Njeriut – të gjitha vendimet do të merren në përputhje me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- d. Të qenurit i hapur dhe lejimi i aksesit – në të gjitha çështjet tendenca duhet të jetë në favor të të qenurit i hapur.
- e. Qartësisë – duhet të jenë të qarta qëllimet dhe rezultatet e dëshirueshme në marrjen e çdo vendimi.
- f. Alternativës – duhet të jepet një shpjegim i alternativave që u morën parasysh dhe arsyet për marrjen e vendimeve.

NENI 21

MARRËDHËNIET NDËRQEVERITARE

Bashkia nëpërmjet Këshillit të Bashkisë mund të hyjë në marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, me secilën ministri apo agjensi në varësi të Qeverisë për të pranuar grante, marrë hua dhe asistencë nga Qeveria për të bërë përmirësime publike brënda Bashkisë apo për prona Bashkiake jashtë juridiksionit të Bashkisë në rast se Bashkia zotëron pronë apo të drejta bashkarisht me njësi të tjera të qeverisjes vendore.

NENI 22

BASHKËPUNIMI NDËRBASHKIAK

Bashkia nëpërmjet Këshillit Bashkiak mund të hyjë në marrëveshje me njësi të tjera të qeverisjes vendore brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë për mallra e shërbime, ndërtime si dhe për përmirësime publike brënda Bashkisë apo për prona Bashkiake jashtë juridiksionit të Bashkisë.

NENI 23

BASHKËPUNIMI ME TË TJERË

Bashkia nëpërmjet Këshillit Bashkiak mund të hyjë në marrëveshje me agjensi, organizata, korporata, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar, statutin e Bashkisë për mallra e shërbime.

K A P I T U L L I I I I

P U S H T E T I L I G J V E N E S

KREU 1 Autoriteti Ligjvënës

NENI 24

Pushteti ligjvënës i Bashkisë ushtrohet nga Këshilli Bashkiak, si dhe direkt nga populli me anë të referendumeve vendore si dhe nga Kryetari i Bashkisë lidhur me ato funksione që nuk janë kompetence e Këshillit të Bashkisë.

Këshilli i Bashkisë ka kompetencat ligjvënëse që parashikohen nga Ligji 8652 datë 31.7.200 dhe ky Statut; Këshilli i Bashkisë e ushtron pushtetin e tij ligjvënës nëpërmjet nxjerrjes së akteve; por kompetenca për të propozuar çdo akt që ka të bëjë me çdo çështje brenda fushës së çështjeve vendore apo punës së Bashkisë, dhe për të miratuar apo hedhur poshtë këto akte me votim, përveç Këshillit Bashkiak, i rezervohet edhe zgjedhësve të Bashkisë.

Kjo kompetencë mund të ushtrohet nga zgjedhësit me referendum vendor për

miratim ose hedhje poshtë të çdo akti, apo pjese të tij, çdo paragrafi, apo kreu që ka të bëjë me çështjet vendore apo punën e Bashkisë, që mund të jetë miratuar nga Këshilli Bashkiak ose nga Kryetari i Bashkisë.

Këshilli i Bashkisë mund të dekretojë, ose hedhë poshtë çdo nismë ligjore të prezantuar nga zgjedh Bashkisë populli, por nuk ndryshon apo modifikon atë. Ai mund që, gjithsesi, pas rrëzimit të një nisme ligjore të prezantuar nga zgjedhësit, të propozojë dhe miratojë një nismë të ndryshme që bën fjalë për të njëjtën temë.

NENI 25

NISMA LIGJVËNËSE DHE REFERENDUMI

Zgjedhësit e Bashkisë kanë iniciativë ligjvënëse nëpërmjet nismës ligjore të prezantuar në Këshillin e Bashkisë si dhe nismës për referendum vendor. Kompetenca legislative e rezervuar për zgjedhësit ushtrohet me anë të referendumit vendor.

Nisma ligjore mund të prezantohet në Këshillin e Bashkisë nga pesë përqind e zgjedhësve të regjistruar në Bashki.

Dhjetë për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të Bashkisë dhe të

pajisur me kartën e zgjedhësit, ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër të jetë më e vogël, kanë të drejtën e referendumit vendor për një çështje të qeverisjes vendore në Bashki.

Kërkesa për fillimin e procedurave të referendumit paraqitet në KQZ nga një grup prej jo më pak se 12 nismëtarësh, të cilët janë zgjedhës të rregjistruar në rregjistrin Kombëtar të Zgjedhësve dhe të pajisur me kartën e zgjedhësit.

Kërkesa për fillimin e procedurave për referendum për një çështje të një rëndësie të veçantë duhet të përshkruajë qartë çështjen që shtrohet, rëndësinë e saj, si dhe qëndrimin e nismëtarëve në lidhje me atë çështje. Çështja duhet të formulohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe pa ekuivoke dhe në mënyrë të tillë që zgjedhësit të mund të përgjigjen me “Po” ose “Jo”.

Referendumi për të njejtën çështje nuk mund të përsëritet në të njejtën njësi të qeverisjes vendore pa kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

NENI 26

NJOFTIMI DHE KRYERJA E REFERENDUMIT

Pranimi i kërkesës për referendum vendor, publikimi zyrtar, dhënia e njoftimit të

zgjedhjeve, mënyra dhe kryerja e tyre, përgatitja e fletëve të votimit, numërimi dhe mbledhja e votave, dhe vërtetimi i rezultateve të zgjedhjeve bëhet siç është parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 8609 dt. 08. 05. 2000. “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

NENI 27

ALTERNATIVA FITUESE NË REFERENDUMIN VENDOR.

Alternativa fituese, (alternativa që merr shumicën e të gjitha votave), merr formë të prerë, dhe hyn në fuqi 10 ditë pasi botohet në fletoren zyrtare të Bashkisë. Kur alternativa fituese e miratuar parashikon shpenzime që nuk përfshihen në buxhetin aktual, ose që nuk mund të paguhet nga fondet aktuale, ose që zhduk apo pakëson një të ardhur ekzistuese të Bashkisë ajo hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të buxhetit pasardhës. Kur vetë alternativa fituese në referendum përcakton një datë të mëvonshme për hyrjen në fuqi, shpallja përmend datën e caktuar si kohë të hyrjes në fuqi.

NENI 28

Çdo akt që i është paraqitur Këshillit të Bashkisë dhe që do të marrë shumicën e të gjitha votave, bëhet vendim, dhe hyn në fuqi me shpalljen nga Kryetari i Bashkisë që bëhet dhe publikohet në gazetën zyrtare Bashkiake brenda ____ ditësh nga shpallja.

Kur një vendimi i tillë parashikon shpenzime që nuk përfshihen në buxhetin aktual, ose që nuk mund të paguhet nga fondet aktuale, ose që zhduk apo pakëson një të ardhur ekzistuese ajo hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të buxhetit pasardhës. Ky kufizim i hyrjes në fuqi nuk vlen kur shpenzimi ose e ardhura që zvogëlohet nuk kalojnë shumën prej _____ lekë.

NENI 29

VLEFSHMËRIA E AKTEVE.

Një akt i Këshillit të Bashkisë quhet i ligjshëm/vlefshëm nëse ai është miratuar në një Mbledhje Zyrtare, ku është shqyrtuar dhe votuar sipas procedurave ligjore, këtij Statutit, rregullores së Këshillit Bashkiak dhe është i regjistruar në Proçesverbalin i Mbledhjes, ky i fundit i firmosur nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit të Mbledhjes dhe Sekretari, është ratifikuar,

shpallur dhe ka hyrë në fuqi në përputhje me ligjin, Statutin e Bashkisë dhe këtë rregullore të Këshillit të Bashkisë.

NENI 30

E DREJTA E VOTËS

Anëtari i Këshillit të Bashkisë nuk mund të delegojë të drejtën e votës. Është detyrë e çdo anëtari i Këshillit të Bashkisë të votojë në një mbledhje zyrtare dhe të vlefshëm të Këshillit, kur votimi kërkohet dhe kryhet sipas procedurave të ligjshme apo/dhe të miratuara nga Këshilli. Votimi është individual.

NENI 31

NËNSHKRIMI I PROJEKT VENDIMEVE

Çdo projekt vendim, pasi miratohet nga Këshilli, nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit në mbledhje radhës të hapur të Këshillit, për të vërtetuar miratimin e tij. Gjatë nënshkrimit Kryetari tërheq vëmendjen tek projekt vendimi, dhe që ai/ajo po e nënshkruan atë, dhe, nëse çdo anëtar kërkon, projekti lexohet i tëri për informacion në lidhje me korrektësinë e tij kur regjistrohet. Nëse një anëtar vë re që projekti nuk është i njëjti me atë që u

shqyrtua dhe u miratua, një kundërshtim i tillë shqyrtohet, dhe nëse mbështetet Kryetari tërheq nënshkrimin e tij ose të saj dhe projekt vendimi ndreqet dhe nënshkruhet para se Këshilli të proçedojë me ndonjë çështje tjetër.

NENI 32

Një akt i shqyrtuar për blerje apo shitje prone të Bashkisë apo një akt që trajton elementë të planifikimit urban apo të menaxhimit të tokës të Bashkisë nuk mund të rikonsiderohet nga Këshilli e Bashkisë pa kaluar një afat dy mujor nga mbledhja ku mocioni, për çështjet e përmendura në këtë paragraf, është refuzuar me votim. Një projekt- rregullorë, e refuzuar me votim, mund të rishqyrtohet pas katër muajsh nga data e mbledhjes ku u refuzua, apo menjëherë pas zgjedhjes së një Këshilli të ri.

NENI 33

REGJISTRIMI DHE PUBLIKIMI I PROJEKT VENDIMEVE DHE REZOLUTAVE

Të gjitha vendimet dhe rezolutat depozitohen tek Sekretari i Bashkisë që i regjistron ato. Të gjitha vendimet e një natyre të përgjithshme, publike ose të

përhershme, dhe ato që vendosin gjoba, dënime apo konfiskime, publikohen të paktën një herë në fletoren zyrtare të Bashkisë brenda tre ditësh pas bërjes shpalljes; Me kusht që publikimi i të gjitha vendimet që akordojnë të drejtë ekskluzive ose privilegj privat ose që miratojnë ose lirojnë një hapësirë ndërtimi bëhet me shpenzimet e aplikantit.

Çdo vit në Janar me shpenzime të Bashkisë, Sekretari i Bashkisë përpilon të gjitha vendimet e shpallura në vitin paraardhës, që kërkohet të publikohen, dhe ai/ajo shtyp, indeksin dhe lidh në libra me kapakë të fortë kopje të tyre. Një numër i mjaftueshëm i këtyre librave u jepet gjithë anëtarëve të Këshillit të Bashkisë dhe krerëve të departamenteve, dhe e pakta njëqind kopje vihen në dispozicion për shpërndarje të përgjithshme në publikun e gjerë.

Publikimi i të gjitha vendimet dhe rezolutat brenda (*tri*) ditësh nga shpallja apo miratimi i tyre është udhëzim; publikimi brenda (*gjashtë*) ditësh është detyrim.

Një gazetë e përditshme prej katër faqesh që përmban njoftime të përgjithshme me dominim shpalljen e vendimeve të Këshillit me qarkullim nga 750 deri në 1,000

pajtimtarë në Bashki quhet gazetë për publikimin e shtypit të Bashkisë.

NENI 34

EKSKLUZIVITETET

Akordimi i një ekskluziviteti, të drejte ose privilegji është e drejtë e Këshillit të Bashkisë, ose e popullit të Bashkisë që, në çdo kohë pas akordimit të lejes, vepron vetë me iniciativë dhe referendum për të hedhur poshtë, ndryshuar ose modifikuar lejen e dhënë duke pasur parasysh të drejtat e përfituesit dhe interesin e publikut.

Këshilli i Bashkisë nuk merr parasysh aplikime ose nuk akordon zgjerim të periudhës së ekskluzivitetit, as edhe ekskluzivitet të ri që mbulon gjithë ose çdo pjesë thelbësore të të drejtave ose privilegjeve të çdo ekskluziviteti ekzistues, deri sa brenda tre vjetëve nga skadimi i ekskluzivitetit ekzistues, dhe vetëm atëherë kjo të jetë miratuar nga Këshilli i Bashkisë me 2/3 votave të anëtarëve të Këshillit.

Jo më pak se një e treta e të gjithë anëtarëve të Këshillit pa petition mund të thërrasë një referendum mbi një vendimi ekskluziviteti.

NENI 35

KUSHTET E EKSKLUZIVITETIT TË SKELËS (SHËMBULL I NJË EKSKLUZIVITETI SPECIFIK)

Këshilli i Bashkisë nuk jep asnjë të drejtë ekskluziviteti për ndonjë skelë përveç sipas mënyrës që vijon: përveç kërkesave të ligjeve të përgjithshme, çdo vendim që akordon ekskluzivitet duhet të marrë votën e të paktën dy të tretave të të gjithë anëtarëve të Këshillit, dhe parashikon që puna fillon brenda gjashtë muajve dhe do të vijojë vazhdimisht dhe kryhet brenda vitit pasardhës. Kjo kohë nuk zgjatet për asnjë arsye, dhe përveç kur kjo plotësohet e drejta e ekskluzivitetit humbet.

NENI 36

EKSKLUZIVITETET QË NDALOHEN

E drejta ekskluzive ose privilegji nuk jepet për përdorim rrugësh ose vendi tjetër ose çdo pjese të tyre.

KREU 2 Këshilli i Bashkisë

NENI 37

KËSHILLI BASHKIAK, ANËTARËT

Këshilli i Bashkisë përbëhet nga këshilltarët të cilët zgjidhen indirekt nga populli në bazë të listave të subjekteve politike konkurruese në zgjedhjet administrative për Bashkinë.

Numri i anëtarëve të Këshillit të Bashkisë është ___ persona.

NENI 38

PAPAJTUESHMËRIA E FUNKSIONIT TË KËSHILLTARIT

Funksioni i Këshilltarit është i papajtueshëm me:

- funksionin e Kryetarit, z/Kryetarit të Bashkisë;

- funksionin e Sekretarit të Këshillit të Bashkisë;
- funksionin e nëpunësit të administratës së Bashkisë;
- funksionin e deputetit.

Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një Këshill Bashkie.

Nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit personat që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrrri e vjehrra me nusen dhe dhëndërin.

NENI 39

KOMPETENCA NËPËRMJET VENDIMIT

Këshilli i Bashkisë ka dhe ushtron kompetencat e tij nëpërmjet vendimeve të marra në një mbledhje zyrtare dhe të ligjshme dhe asnjë mënyre tjetër.

NENI 40

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT TË BASHKISË

Këshilli i Bashkisë ka këto detyra dhe kompetenca:

1. Miraton statutin e Bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
2. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe z/Kryetarin e Këshillit.
3. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Këshillit.
4. Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së Bashkisë, të agjensive në varësi të Bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këshilli i Bashkisë mund, të riorganizojë strukturën organizative të Bashkisë për drejtimin e funksioneve bashkiake përveç se kur ky riorganizim ndalohet me dispozita të tjera të këtij Statuti.

5. Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose është bashkëthemelues.
6. Miraton buxhetin e Bashkisë dhe ndryshimet e tij.
7. Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të Bashkisë të tretëve.
8. Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të Bashkisë.
9. Vendos për taksat e tarifatat vendore, si dhe nivelin e tyre.
10. Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Çdo borxh ose detyrim i çdo lloji ndaj Bashkisë krijohet vetëm me akt të Këshillit të Bashkisë që specifikon shumën dhe objektin e një shpenzimi të tillë.
11. Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.

12. Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.
13. Zgjedh përfaqësuesit e Këshillit të Bashksë në Këshillin e Qarkut.
14. Vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të Këshilltari të Bashkisë.
15. Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
16. Vendos për simbolet e Bashkisë.
17. Vendos për emërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të agjensive dhe të objekteve në juridiksionin e Bashkisë.
18. Jep tituj nderi dhe stimuj.
19. Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në Bashki.”
20. Vendos për lidhjen e kontratave ku Bashkia është palë. Pasi miratohet në

Këshillin e Bashkisë kontrata firmoset nga Kryetari i Bashkisë.

21. Mban një protokoll publik të procedimeve të tij, dhe mban Po-të, Jo-të dhe Abstenimet për çdo çështje me kërkesë të çdo dy anëtarëve dhe e regjistron këtë në protokoll.
22. Ka autoritet për të dënuar anëtarët e tij dhe të tjerë për sjellje të parregullt ose përbuzëse në prani të vet, dhe të përjashtojë për këtë sjellje në prani të tij çdo anëtar me votën pohuese të jo më pak se dy të tretave të anëtarëve të tij, duke shprehur shkakun në urdhrin e përjashtimit (*detajet e ushtrimit të kësaj kompetence specifikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të Bashkisë*).
23. Ka autoritet të krijojë dhe përdorë komisione me anëtarë të tij për të lehtësuar funksionet e tij ligjvënëse; me kusht që asnjë komision i Këshillit dhe asnjë anëtar të mos ketë apo ushtrojë pushtet ekzekutiv ose administrativ pranë Bashkisë.
24. Ka autoritet të kërkojë praninë e dëshmitarëve si edhe hartimin, para tij apo secilit prej komiteteve të tij, të

relacioneve dhe çështjeve që i përkasin veprimtarisë së Këshillit.

25. Kontrollon financat dhe pronat e Bashkisë; me kusht që Këshilli i Bashksë të mos ketë pushtet ekzekutiv.
26. Përfiton përmes blerjes ose ushtrimit të së drejtës së shpronësimit, për të shfrytëzuar në emër të Bashkisë, troje e pasuri të tjera brenda dhe jashtë kufijve të bashkisë si të gjykohet e duhur për çdo përdorim të përbashkët, dhe të përfitojë për Bashkinë çdo pronë përmes dhurimit, trashëgimisë, dhe të disponojë këto prona sipas interesave të Bashkisë.
27. Ndërton, blen, shpronëson ose ndryshe përfiton, mirëmban dhe vë në punë ndërrmarrje dhe prona publike brenda ose jashtë Bashkisë për qëllimet që vijojnë: furnizimin me ujë për përdorim shtëpiak apo të gjitha llojet e tjera, prodhimin e gazit dhe elektricitetit për ndriçim, ngrohje, energji dhe të gjitha përdorimet e tjera publike dhe private; sistemin e transportit publik; shërbimin telefonik (tragete me largësi të vogla e të gjata, doket dhe lehtësira terminali; dhe të kontrollojë përdorimin e tyre, dhe të caktojë çmimin e shërbimeve dhe produkteve të tyre).

28. Bën rregullore vendore, policie, shëndetësore dhe rregullore të tjera që nuk janë në kundërshtim me ligjet e Republikë së Shqipërisë.
29. Tjetërson, ndryshon ose shfuqizon çdo akt ose akte ose pjesët e tyre, përveç kur këtu parashikohet ndryshe.
30. Emëron përfaqësuesit e Bashkisë në organet ku përfaqësohet bashkia përveç kur emërimi është funksion i ekzekutivit ose është deleguar nga Këshilli i Bashkisë.
31. Miraton të gjitha rregullat dhe rregulloret e nevojshme për të zbatuar të gjitha kompetencat që, me këtë Statut ose me ligj, i vishen Bashkisë ose çdo njësie organizative, përveç kur ky Statut parashikon ndryshe.

NENI 41

USHTRIMI I KOMPETENCAVE

Këshilli bën të gjitha rregullat dhe rregulloret e nevojshme ose të duhura për të zbatuar të gjitha kompetencat që, me këtë Statut ose me ligj, i vishen Bashkisë ose çdo departamenti a zyrtari, përveç kur ky Statut parashikon ndryshe.

Për ushtrimin e kompetencave dhe zbatimin e detyrave të tij Këshilli i Bashkisë strukturon vetveten, marrëdhëniet në mes Këshilltarëve, me Kryetarin dhe administratën e Bashkiake, agjensitë në vartësi të Bashkisë, me komunitetin dhe organizatat e tjera jashtë Bashkisë. Strukturimi i punës së Këshillit të Bashkisë dhe i marrëdhënieve të tij me organizma të tjerë bëhet nëpërmjet:

- Rregullores së Këshillit të Bashkisë.
- Komisioneve, Komiteteve apo Bordeve të Përhershme apo të Përkohshme.
- Marrëveshje me organizata të tjera jashtë Bashkisë.

Në institucionalizimin dhe strukturimin e këtyre marrëdhënieve Këshilli i Bashkisë merr parasysh prioritetet e zhvillimit të gjithanshëm të Bashkisë, problemet madhore me të cilat përballohet Bashkia dhe burimet njerëzore dhe natyrore që ekzistojnë në dhe përreth Bashkisë (p.sh. nëse një bashki ka një burim të madh natyror si liqeni, Këshilli i Bashkisë ngre një komision të përhershëm për liqenin, komision i cili do të merret me çështjet e liqenit si dhe me çështje që kanë të bëjnë me

zhvillimin e turizmit përreth tij dhe ruajtjen e florës dhe faunës së tij).

KREU 3 Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë

NENI 42

Autoriteti i Këshilli i Bashkisë ushtrohet vetëm në Mbledhje të Këshillit të Bashkisë dhe nëpërmjet Korumit të kërkuar nga ligji dhe ky statut.

NENI 43

PLANI PARAPRAK I PUNIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË

Këshilli i Bashkisë në mbledhje e parë të, çdo viti, duhet të miratojë planin paraprak të mbledhjeve të tij për vitin në vazhdim.

NENI 44

MBAJTJA E MBLEDHJES SË KËSHILLIT

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë zhvillohet kur në të marrin pjesë të paktën mbi 50% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Njoftimi, afatet, rendi i ditës, mënyra e mbajtjes së proçesverbaleve dhe minutat e mbledhjeve të Këshillit, si dhe çështje të tjera organizative përshkruhen me detaje nga Rregullorja e Brendëshme e Këshillit të Bashkisë.

NENI 45

NJOFTIMI PËR PUBLIKUN

Njoftimi për publikun për mbledhjet e Këshillit të Bashkisë bëhet nga Sekretari i Këshillit, dhe në mungesë të tij nga Kryetari apo Z/kryetari, në median vendore, në tabelën informative jashtë dhe afër ndërtesës kryesore të Bashkisë, dhe në gazetën e Bashkisë, nëse kjo e fundit shpërndahet brenda afatit të njoftimit. Sekretari njofton të gjithë ato persona apo organizata të cilat kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt për çdo mbledhje të Këshillit të Bashkisë.

Njoftimi për publikun i mbledhjes bëhet me: media vendore; botim në gazetën Bashkiake; shpallje në hollin e Bashkisë/ zyrën e informacionit, në tabelën e njoftimeve bashkiake; me postë; telefon. Sekretari vendos për mënyrën e njoftimit në rastet e kërkesave për njoftim të bëra nga individë apo organizata.

NENI 46

MBLEDHJET E KËSHILLIT

Këshilli për ushtrimin e funksioneve të tij mban Mbledhje të Hapura dhe të Mbledhje të Mbyllura të cilat mund të jenë:

- Të Rregullta
- Jashtë Radhe
- Emergjente

NENI 47

MBLEDHJET E RREGULLTA TË KËSHILLIT

Mbledhjet e Rregullta të Këshillit të Bashkisë thirren nga Kryetari ose në mungesë të tij nga Z/Kryetari. Mbledhjet mbahen të Mërkurën e tretë të Janarit, Shkurtit, Marsit, Prillit, Majit, Shtatorit, Tetorit dhe Nëntorit; të Enjten e tretë të

Qershorit, Korrikut, Gushtit; dhe të Mërkurën e dytë të Dhjetorit. Në rast se secila nga këto ditë është ditë feste mbledhje mbahet ditën pasardhëse të punës.

Të gjitha mbledhjet e rregullta të Këshillit mbahen brënda juridiksionit të Bashkisë. Mbledhja mbahet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, përveç se kur Këshilli me shumicë votash në mbledhjen paraardhëse, vendos të takohet në një vend tjetër.

NENI 48

MBLEDHJET E JASHTË RADHE TË KËSHILLIT

Mbledhjet Jashtë Radhe thirren (ligji 8652 neni 31 pika 3).

- me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë;
- me kërkesën e 1/3 së Këshilltarëve të tij;
- me kërkesën e motivuar të Prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij”.

Mbledhjet jashtë radhe mbahen në datën, vendin dhe kohën e caktuar nga Kryetari i Këshillit. Në mbledhje konsiderohen vetëm ato çështje për të cilat është thirrur mbledhja.

Për mbledhje jashtë rradhe njoftimi për Këshilltarët dhe publikun bëhet minimalisht dyzet e tetë (48) orë para mbajtjes së mbledhjes. Në rastin e mbledhjes emergjente njoftimi Këshilltarëve i bëhet me telefon apo gojarisht së paku një orë para mbajtjes së mbledhjes. Këshilltarët depozitojnë pranë Sekretarit numrin e telefonit apo mënyrën me të cilën ato mund të kontaktohen shpejt.

NENI 49

MBLEDHJET EMERGJENCE TË KËSHILLIT

Mbledhje Emergjence mbahen në çdo kohë kur ajo thirret nga Kryetari i Këshilli ose kur atij i kërkohet kjo nëpërmjet një kërkese me shkrim ku është sqaruar arsyeja e thirrjes së mbledhjes emergjente, çështja që do të trajtohet dhe që është firmosur nga:

- a. 1/3 e Këshilltarëve;
- b. Kryetari i Bashkisë.
- c. Prefektit, për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

Kërkesa për mbledhje duhet të specifikojë shkurtimisht natyrën dhe objektin e çështjes emergjente përshqyrtimin e së cilës kërkohet të mbahet mbledhja. Në

Mbledhjen Emergjente shqyrtohen vetëm çështjet për të cilat është thirrur mbledhja.

Kur në territorin e Bashkisë ekziston një emergjencë në të cilën nevojitet ruajtja e menjëhershme e qetësisë, shëndetit ose sigurisë publike, Kryetari i Këshillit të Bashkisë ka të drejtë të prezantojë në Këshilli një projekt-vendim. Që një vendim i tillë të hyjë në fuqi pa vonesë, kjo emergjencë dhe nevojë, si dhe faktet që krijojnë atë deklarohen në një paragraf të vendimit. Projekti bëhet vendim kur votohet PRO nga Këshilli i Bashkisë me të paktën tre të katërtat (3/4) e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Bashkisë.

NENI 50

MBLEDHJET E MBYLLURA.

“Këshilli me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të Këshilltarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur” (Ligji nr 8652 neni 34 pika 3).

Mbledhja e Mbyllur mbahet vetëm pasi një vendim i tillë është marrë sipas procedurave ligjore, Statutit të Bashkisë dhe kësaj rregulloreje, nga shumica e Këshilltarëve të pranishëm në një mbledhje të hapur ku do të specifikohet arsyeja, një nga 10 arsyet e

përmendura më poshtë për mbajtjen e mbledhjes së mbyllur. Mbledhja e mbyllur lejohet të mbahet vetëm për t'i lejuar Këshillit për të vepruar në interes të publikut që përfaqëson. Mbledhja e mbyllur mund të mbahet edhe për një pikë të rendit të ditës.

Votimi për mbajtjen e një mbledhjeje të mbyllur bëhet i hapur. Kryetari shpall rezultatet e votimit, të përcjellura më parë nga Sekretari, dhe deklaron mbajtjen e mbledhjes së mbyllur.

Motivi për të kërkuar një mbledhje të mbyllur. Këshilli mund të mbajë një mbledhje të mbyllur kur kjo kërkohet për të:

1. Penguar zbulimin e një informacioni të privilegjuar dhe konfidencial (jo publik), i përcaktuar si i tillë me ligji (psh informacion për personat që marrin ndihmë ekonomike).
2. Konsultuar me një avokat i punësuar apo i marrë nga Këshilli me qëllim për të mbrojtur privilegjin e marrëdhënies avokat-klient, kur Këshilli ka nevojë të konsiderojë dhe të instruktojë avokatin lidhur me trajtimin apo zgjidhjen e një ankese, veprimi juridik apo procedurë administrative.

3. Konsideruar fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së Këshillit.
4. Konsideruar çështje që kanë lidhje vendosjen dhe/apo zgjerimin e një industrie apo bizneseve të tjera në zonën ku ka autoritet Këshilli.
5. Vendosur apo instruktuar stafin administrativ për kushtet e kontratave kolektive, shpërblimet, caktimet e rrogave dhe ankesat për nëpunësit bashkiak.
6. Konsideruar apo instruktuar stafin bashkiak apo agjentin negociues në lidhje me pozicionin që duhet të marrë Këshilli në negocimin e çmimit apo termave të tjera materiale të një kontrate apo propozim kontrate për përfitim të pasurisë së paluajtshme me anë të blerjes, shkëmbimit apo marrjes me qera, masën e kompensimit dhe terma të tjera të kontratës së punësimit apo propozim për kontrata punësimi.
7. Konsideruar konflikte mes Këshilltarësh si dhe në mes Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë dhe stafit të tij.

8. Konsideruar ankesa kundrejt Këshilltarëve, Kryetarit dhe stafit të Bashkisë.
9. Planifikuar, raportuar apo dëgjuar raporte që kanë lidhje me hetime të sjelljeve kriminale.
10. Penguar daljen e parakohshme të informacionit për një titull honorifik, apo çmim.

Për pikat 4, 5, 6 dhe 7 vendimi i Këshillit merret në një mbledhje të hapur.

Çështje të cilat konsiderohen në një Mbledhje të Mbyllur i duhen njoftuar publikut. Persona jo Këshilltarë mund të lejohen të marrin pjesë në një Mbledhje të Mbyllur nëse ato ndihmojnë në konsiderimin e çështjes/ve dhe kur për këtë vendos shumica e Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

Materialet e paraqitura dhe të konsideruara në një Mbledhje të Mbyllur nuk janë rekord publik dhe nuk lejohet rregjistrimi i mbledhjes me mjete video apo audio as nga vetë Këshilltarët. Ato mund të bëhen rekord publik vetëm mbas rënies së shkaktuar për të cilën është mbajtur Mbledhja e Mbyllur. Nëse e lejon ligji, Këshilli i mëpasshëm mund të vendosë të hapë për inspektim publik rekordet e

Mbledhjeve të Mbyllura të Këshillit/ave të mëparshëm.

NENI 51

GRUPI POLITIK

Dy ose më shumë anëtarë të Këshillit kanë të drejtë të krijojnë një grup politik. Ky grup politik konsiderohet si i formuar në momentin që firmatorët dorezojnë tek Kryetari i Këshillit, në një mbledhje të hapur të Këshillit, kërkesën e firmosur për njohjen e një grupi të tillë. Kjo kërkesë duhet të përmbajë shprehjen e dëshirës së firmëtarëve për krijimin e një grupi politik, të specifikojë emrin e grupit dhe emrin e drejtuesit të grupit.

NENI 52

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Në mbledhjen e tij të parë Këshilli zgjedh Kryetarin e tij. Kryetari i Këshillit zgjidhet me shumicën e thjeshtë të votave të këshilltarëve të pranishëm në mbledhjen e parë të Këshillit. Rregullat e votimit shpjegohen në rregulloren e brendshme të Këshillit.

NENI 53

KOMPETENCAT E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË.

Kryetari dhe Z/Kryetari i Këshillit Bashkiak, zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet nga të paktën një e treta e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit kryen këto detyra:

- thërret mbledhjen e Këshillit Bashkiak;
- drejton mbledhjet e Këshillit në përputhje me rregulloren e tij;
- nënshkruan aktet që nxjerr Këshilli;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në rregulloren e Këshillit.

Në mungesë të Kryetarit të Këshillit, detyrat e tij i kryen Z/Kryetari.

NENI 54

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

1. Sekretari i Këshillit emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Bashkiak, mbi bazën e propozimit të Kryetarit të Këshillit, me shumicën e votave të

numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

2. Sekretari i Këshillit Bashkiak është përgjegjës për:

- mbajtjen e dokumenteve zyrtare të Këshillit;
- ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës;
- njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit;
- shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak;
- përgatitjen e seancave të Këshillimit me bashkësinë;
- mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të Këshillit.

3. Sekretari i Këshillit Bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë Këshilli.

NENI 55

PAPAJTUESHMËRIA E FUNKSIONIT TË KËSHILLTARIT

Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

1. funksionin e Kryetarit, z/Kryetarit të Bashkisë;
2. funksionin e sekretarit të Këshillit Bashkiak;
3. funksionin e nëpunësit të administratës së Bashkisë _____;
4. funksionin e deputetit.

Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një Këshill Bashkiak.

Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit Këshill Bashkiak personat që janë me njëritjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen dhe dhëndrin.

NENI 56

KOMISIONET E PËRHERSHME TË KËSHILLIT

Komisionet e Përhershme emërohen nga Këshilli i Bashkisë për të realizuar funksionet e Këshillit.

Të drejtën për të qenë anëtarë të këtyre komisioneve e kanë vetëm anëtarët e Këshillit.

Të gjithë anëtarët e Këshillit duhet të jenë anëtarë të njërit nga komisionet e përhershme.

Secili nga Komisionet përbëhet minimalisht nga tre anëtarë.

Kryetari i Këshillit nuk lejohet të jetë kryetar i një komisionit të përhershëm.

Këshilli përcakton përbërjen e komisioneve dhe përgjegjësitë dhe detyrat e tyre specifike.

Secili komision do të ketë kryetarin dhe nënkryetarin e tij që do të zgjidhen nga anëtarët e komisionit.

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve ku anëtarë të të cilit nuk janë, me përjashtim të rasteve

kur këto mbledhje janë të mbyllura ashtu siç specifikohet në këtë Statut.

Komisionet mbajnë mbledhje të hapura përveç rasteve kur trajtojnë çështje konfidenciale dhe ku prezantohet informacion i rezervuar, sipas specifikimeve të ligjit për informimin publik dhe këtij statuti.

Kryetari i Komisionit me vendim të komisionit mund t'i propozojë këshillit emërimin pranë komisionit të një numri personash të kooptuar dhe jo-votues deri në 1/3 e numrit të anëtarëve të komisionit.

NENI 57

ROLI I KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

Brënda termave të tyre të references, komisionet e përherëshme do të:

- Rishikojnë ose shqyrtojnë vendimet ose veprimet e ndërmarra në lidhje me kryerjen e funksioneve që janë përgjegjësi e ekzekutivit.
- Raportojnë ose bëjnë rekomandime në Këshill në kuadër të kryerjes të funksioneve nga ekzekutivi i Bashkisë.

- Raportojnë dhe bëjnë rekomandime në Këshillin e Bashkisë ose pranë Kryetarit të Bashkisë për çështje që lidhen me Bashkinë ose banorët e saj.
- Ushtrojnë të drejtën të thërrasin zyrtarë të ndryshëm të Bashkisë për të kërkuar sqarime nga ana e tyre lidhur me mos-ekzekutimin e vendimeve të marra.

NENI 58

FUNKSIONET SPECIFIKE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME

Komisioneve të përhershme kanë funksionet specifike të mëposhtme:

1. Hartimi dhe rishikimi i politikave.
 - Asistojnë Këshillin dhe Kryetarin e Bashkisë në përgatitjen e buxhetit dhe politikave nëpërmjet analizave të çështjeve të politikave.
 - Realizojnë kërkime si dhe konsultime me komunitetin dhe aktorë të tjerë të interesuar me qëllim analizimin e çështjeve të politikave dhe opsioneve të mundshme.

- Marrin në shqyrtim dhe zbatojnë mekanizma që inkurajojnë dhe rrisin nivelin e pjesëmarrjes së komunitetit në zhvillimin e opsioneve të politikave.
 - Marrë mendimin e ekzekutivit të Bashkisë mbi çështje dhe propozime të ndryshme.
 - Krijojë komunikim dhe bashkëpunim me organizatat e huaja që veprojnë në territorin e Bashkisë qofshin ato ndërkombëtare, kombëtare, rajonale, apo vendore.
2. Financat. Përdorin fondet që mund t'i alokohen atyre me qëllim realizimin e funksionve të komisionit.
 3. Raportet vjetore. Raportojnë çdo vit në Këshill mbi punën e tyre si dhe të bëjnë rekomandime për programe pune në të ardhmen.

NENI 59

KOMISIONET E KËSHILLIT BASHKIAK

Komisionet e Këshillit të Bashkisë _____ janë (*shëmbull*):

1. Komisioni i Burimeve Financiare dhe Pronave Publike
2. Komisioni i Mandateve dhe Protokollit
3. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Infrastruktues
4. Komisioni i Punëve dhe Shërbimeve Publike
5. Komisioni i Revizionimit të Bashkisë
6. Komisioni i Çështjeve Juridike dhe Kontratave
7. Komisioni i Rendit, Qetësisë dhe Emergjencave Publike
8. Komisioni i Zhvillimit Ekonomik dhe Biznesit
9. Komisioni i Shërbimeve Sociale, Shëndetit Publik dhe Mjedist
10. Komisioni i Arsimit, Kulturës dhe Argëtimit
11. Komisioni i Organizimit dhe Personelit
12. (Shënim: Lista e komisioneve të përmendura më sipër është një listë orientuese. Numri, përbërja dhe emërtesa e këtyre komisioneve do të

varet nga numri i anëtarëve të këshillit dhe nga prioritetet e zhvillimit dhe specifikave që ka çdo Bashki).

NENI 60

KOMISIONI I BURIMEVE FINANCIARE DHE PRONAVE PUBLIKE

Komisioni i Burimeve Financiare dhe Pronave Publike është komisioni i të gjithëve, që nënkupton që të gjithë anëtarët e Këshillit të Bashkisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këtij komisioni por të drejtë vote kanë vetëm ato që janë anëtarë të përhershëm të këtij komisioni.

Komisioni përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë.

Komisioni ka të drejtë të hetojë transaksionet dhe llogaritë e bëra nga të gjithë zyrtarët që merren me mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e parave publike të Bashkisë.

Komisioni ka mundësi të lirë hyrjeje në çdo regjistër, libër dhe shkresa në të gjitha zyrat publike dhe mund të administrojë betime ose pohime, të pyesë dëshmitarë dhe të detyrojë paraqitjen e tyre me anë të fletë-thirrjes.

Komisioni mban një regjistrim të procedimeve të tij, me emrat e dëshmitarëve të pyetur, dhe një deklaratë thelbësore të provës së marrë. Nëse prej çdo pyetje të bërë nga ky Komision del që nga një zyrtar është kryer një kundërvajtje në detyrë ose një shpërdorim, Komiteti menjëherë i raporton Kryetarit të Bashkisë. Nëse ai ose ajo miraton këtë raport, menjëherë pezullon këtë zyrtar, dhe ndërmerr hapat e duhura sipas këtij Statuti dhe ligjeve në fuqi për ta larguar atë nga puna.

NENI 61

MIRATIMI I AKTEVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË

Çdo projekt-akt, pasi miratohet, nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit në mbledhjen e hapur ku merret vendimi, apo në mbledhjen e hapur pasardhëse, për të vërtetuar miratimin e tij.

Gjatë nënshkrimit Kryetari tërheq vëmendjen tek projekt-akti, dhe që ai ose ajo po e nënshkruan atë dhe, nëse çdo anëtar kërkon, projekti lexohet i tëri për informacion në lidhje me korrektësinë e tij kur regjistrohet.

Nëse një Këshilltar vë re që akti nuk është i njëjti me atë që u shqyrtua dhe u miratua,

një kundërshtim i tillë shqyrtohet, dhe nëse mbështetet Kryetari i Këshillit tërheq nënshkrimin e tij ose të saj dhe projekt-akti ndreqet dhe nënshkruhet para se Këshilli të procedojë me ndonjë çështje tjetër.

NENI 62

KALIMI I AKTEVE KRYETARIT TË BASHKISË

Çdo akt që është miratuar, brenda pesë ditësh, i kalohet për zbatim Kryetarit të Bashkisë.

Nëse Kryetari i Bashkisë vëren se akti çënon interesa të Bashkisë ka të drejtë ta kthejë aktin në Këshill për rishqyrtim brenda 5 ditëve pasi e ka marrë atë. Nëse Kryetari i Bashkisë e kundërshton aktin ai, kur e kthen atë, specifikon me shkrim kundërshtimet e tij.

Këshilli, jo më shpejt se pesë ditë pas shprehjes së Kryetarit të Bashkisë dhe brenda tridhjetë ditësh nga kthimi i aktit, e rishikon dhe voton për aktin. Vota për këtë rishikim merret me Po dhe Jo, dhe emrat e anëtarëve që votojnë pro dhe kundër projekt-aktit shënohen në protokollin e mbledhjes së Këshillit.

NENI 63

REGJISTRIMI DHE PUBLIKIMI I AKTEVE DHE REZOLUTAVE

Të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli i Bashkisë depozitohen tek Sekretari i Këshillit që i regjistron ato. Të gjitha aktet e një natyre të përgjithshme, publike ose të përhershme, dhe ato që vendosin gjoba, dënime apo konfiskim, publikohen të paktën një herë në fletoren zyrtare të Bashkisë brenda dhjetë ditësh pas miratimit në këshill.

Çdo vit në muajin Janar, me shpenzime të Bashkisë, Sekretari i Këshillit seleksionon të gjitha aktet e shpallura në vitin paraardhës, që kërkohet të publikohen siç tregohet në paragrafin paraardhës, dhe ai ose ajo shtyp, indeksin dhe lidh në libra me kapakë të fortë kopje të tyre.

Shënim: (Publikimi i akteve brenda pesë ditësh është udhëzim; publikimi brenda dhjetë ditësh është detyrim.

K A P I T U L L I I V

Q Y T E T A R Ë T

NENI 64

TË DREJTAT E QYTETARËVE

Qytetarët e Bashkisë kanë të drejtat e mëposhtme të:

1. Votimit dhe petitionit. Qytetarët e Bashkisë ___ gëzojnë të drejtën të votojnë në zgjedhje si dhe të firmosin peticione që kërkojnë zhvillimin e një referendumi vendor.
2. Informimit. Qytetarët kanë të drejtë të:
 - të ndjekin takimet e hapura të Këshillit Bashkiak si dhe të komisioneve të Këshillit.
 - ndjekin takimet e administratës së Bashkisë kur diskutohen vendime tepër të rëndësishme.
 - gjejnë në planet paraprake të Bashkisë se çfarë vendimesh të rëndësishme do të merren nga ekzekutivi i bashkisë dhe kur.
 - kenë akses në raportet dhe kopjet e vendimeve të marra nga Këshilli apo ekzekutivi.

- inspektojnë buxhetimin që miraton Këshilli si dhe t'i bëjnë të njohur mendimet e tyre tek auditorë të jashtëm.
3. Pjesëmarrjes. Qytetarët kanë të drejtën për të kontribuar në hetime të kërkuara nga Komisionet e Këshillit kur kjo i kërkohet. Ata mund të bëjnë pyetje në sesionet publike të pyetjeve.
 4. Ankesës. Qytetarët kanë të drejtën e ankesës drejtuar:
 5. Këshillit, sipas skemës së ankesës që do të miratohet nga Këshilli.
 6. Avokatit të Popullit, mbasi është konsumuar ankimi në Këshill;

NENI 65

PËRGJEGJËSITË E QYTETARËVE

Qytetarët janë përgjegjës për të mos qënë violent, abuzues apo kërcënues ndaj Këshilltarëve, Kryetarit dhe zyrtarëve Bashkiasë, apo bashkëqytetarëve të tyre gjatë ushtrimit të detyrave si dhe të mos dëmtojmë me qëllim pasurinë e Bashkisë.

K A P I T U L L I V

P U S H T E T I E K Z E K U T I V

NENI 66

USHTRIMI I PUSHTETIT EKZEKUTIV

Pushteti ekzekutiv në Bashki ushtrohet nga Kryetari dhe administrata e Bashkisë.

NENI 67

KRYETARI I BASHKISË

Kryetari i Bashkisë duhet të jetë shtetas i Republikës Shqipërisë, të plotësojë kushtet e nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të jetë zgjedhës i Bashkisë dhe votues i regjistruar në Bashkinë _____ në kohën e depozitimit të deklaratës së tij ose të saj të kandidimit.

Kryetari i Bashkisë zgjidhet me votim direkt nga populli. Ai shpallet fitues nga komisioni zgjedhor.

Kryetari i Bashkisë ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e tij brenda një mandati 3 vjeçar.

NENI 68

MANDATI I KRYETARIT TË BASHKISË

Mandati i Kryetarit të Bashkisë vërtetohet nga gjykata në juridiksionin e së cilës përfshihet Bashkia, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.

Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të Kryetarit bëhet kur vërehet se nuk plotësohen kushtet sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të Këshillit Bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin sipas formulës së përcaktuar në nenin 28 të ligjit 8652 dhe e nënshkruan atë.

Ushtrimi i mandatit të Kryetarit të Bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin Kryetari pasardhës.

Në rast se Këshilli Bashkiak nuk mblidhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prefekti organizon ceremoninë e betimit të Kryetarit të

Bashkisë në mjediset e Bashkisë dhe në praninë e banorëve të saj.

NENI 69

PËRFUNDIMI PARA KOHE I MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË

Mandati i Kryetarit të Bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur Kryetari:

- nuk pranon të bëjë betimin;
- jep dorëheqjen;
- nuk është më banor i përhershëm i komunës ose bashkisë, ku është zgjedhur;
- shkarkohet nga organi kompetent, sipas nenit 42 të këtij ligji;
- kandidon ose zgjidhet deputet;
- humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
- vdes.

Kryetari i Bashkisë në rastet e dorëheqjes e depoziton atë pranë Këshillit Bashkiak. Sekretari i Këshillit, për ndjekjen e procedurave të nevojshme, njofton prefektin për dorëheqjen e kryetarit.

Për rastet e përfundimit të mandatit të Kryetarit përpara afatit, Këshilli Bashkiak, njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit.

Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Me përfundimin para kohe të mandatit të Kryetarit të Bashkisë sipas këtij neni, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen zëvendëskryetari i Bashkisë. Në rastet kur ka më shumë se një z/kryetar Bashkie, Këshilli Bashkiak, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, cakton një nga zëvendëskryetarët të kryejë funksionet e Kryetarit deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Në rastin kur vendi i Kryetarit të Bashkisë mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, Këshilli Bashkiak zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, i cili ushtron funksionet deri në përfundim të mandatit.

NENI 70

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KRYETARIT TË BASHKISË

Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar Bashkisë si person juridik.

Duhet të jetë vigilent dhe aktiv në zbatimin e akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak;

Në rast emergjence, që çmohet e tillë nga ai, Kryetari i Bashkisë mund të marrë drejtimin e të gjithë ose një pjese të Policisë së Bashkisë. Përpara marrjes së këtij kontrolli ai shpall deklaratën e tij mbi këtë rast, dhe është detyrë e Shefit të Policisë të ekzekutojë urdhrat e shpallura nga Kryetari i Bashkisë gjatë kësaj emergjence.

Është anëtar i Këshillit të Qarkut.

Duhet të jetë vigilent dhe aktiv në zbatimin e akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Ka të drejtë të bëjë komunikime të veçanta me Këshillin Bashkisë herë pas here kur ai e çmon të dobishme dhe të duhur për interesat e Bashkisë dhe ushtrimin e funksioneve të tij.

NENI 71

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KRYETARIT TË BASHKISË

Kryetari i Bashkisë është shefi ekzekutiv i Bashkisë dhe mbikëqyr kujdesshëm të gjitha çështjet bashkiake.

Kryetari i Bashkisë:

- a. Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e Këshillit bashkiak;
- b. Zbaton aktet e Këshillit të Bashkisë;
- c. Merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për Këshillin të Bashkisë, në përputhje me rendin e ditës të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- d. Ushtron kontroll në mënyrë të përhershme mbi sjelljen dhe aktet e hartuara nga të gjithë nëpunësit e Bashkisë;
- e. Merr dhe shqyrton të gjitha ankimet e bëra ndaj nëpunësit e Bashkisë për shkelje dhe neglizhim në detyrë dhe siguron bashkëpunim ndërmjet zyrave

dhe departamenteve të ndryshme të bashkisë dhe ruan qetësi dhe rend në Bashki.

- f. Raporton në Këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të paktën çdo 6 muaj;
- g. Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;
- h. Emëron dhe shkarkon z/kryetarin/ët e Bashkisë; emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi; emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë jodrejtues të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”;
- i. Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- j. Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në Këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkësisë.
- k. Çdo vit përpara se të paraqesë projekt-buxhetin në Këshillin Bashkiak t'i

përshkruajë këtij të fundit gjendjen në të cilën ndodhet Bashkia, si dhe të propozojë ndërmarrjen e masave që ai i konsideron të përshtatshme për përmirësimin e gjendjes së Bashkisë.

- l. Çdo vit, në mbledhjen e tretë të Këshillit Bashkiak në Mars i paraqet Këshillit të Bashkisë një raport mbi gjendjen dhe punët e Bashkisë, dhe të rekomandojë adoptimin e këtyre masave që ai i çmon të përshtatshme dhe me vend;
- m. Kujdeset që të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e bëra me Bashkinë ose për përdorim dhe përfitim nga ajo të zbatohen besnikërisht dhe për këtë qëllim ai ose ajo nis çdo procedurë ligjore ose të paanshme.

NENI 72

SHKARKIMI I KRYETARIT TË BASHKISË

Kryetari i Bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur:

- a. kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;
- b. dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;

- c. propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë.

NENI 73

Kryetari i Bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një (ose më shumë) z/kryetarë. Emërimi dhe shkarkimi i tij (tyre) bëhet nga Kryetari i Bashkisë.

KAPITULLI VI

ADMINISTRATA E BASHKISË

KREU 1 Organizimi i Administratës së Bashkisë

NENI 74

PAVARËSIA E NJËSISË ORGANIZATIVE TË BASHKISË

Njësitë organizative të Bashkisë janë jo politike dhe jo fetare.

NENI 75


Organizimi i Administratës së Bashkisë është funksion i Këshillit të Bashkisë.

NENI 76

Stafi Administrativ i Bashkisë është i organizuar në njësitë organizative sipas organogrames së mëposhtme.

(drejtori, departament apo sektorë, në varësi se cilën nga tre llojet e njësive organizative ka më të larta Bashkia).

Organograma e Bashkisë (shëmbull)



KREU 2 Përbërja dhe Funksionet Bazë të Njësive të Larta Organizative

NENI 77

DEPARTAMENTI JURIDIK

Fuksioni

Detyrat të Përgjithshme (*shëmbull*):

- Departamenti juridik ka për detyrë të shprehet lidhur me përputhshmerinë me ligjin të të gjitha projekt-akteve që dërgohen për miratim në Këshillin e Bashkisë.
- Departamenti juridik i Bashkisë ka kontroll të plotë mbikëqyrës për çështjet ligjore në Bashki, ose në çështje të cilat Bashkia ose një nga njësitë organizative të saj janë të interesuar, dhe kryen

detyra të tjera siç parashikohen me akte të miratuara nga Këshilli I Bashkisë.

- Përfaqëson Bashkinë, me autorizim nga Kryetari i Bashkisë ose nga Këshilli Bashkiak në varësi të çështjes, në procedimet gjyqësore ku Bashkia është palë.
- Mbikëqyr procesin e hartimit të kontratave ku Bashkia është palë.
- Ofron konsulencë juridike për Këshillin e Bashkisë, Kryetarin dhe administratën e Bashkisë.

NENI 78

AVOKATI I BASHKISË

Pozicioni i Avokatit të Bashkisë e zë drejtuesi i Departamentit Juridik. Ai ka kontroll të plotë mbikëqyrës për çështjet ligjore në Bashki, ose në të cilat Bashkia ose një nga departamentet e saj janë të interesuar, dhe kryen detyra të tjera siç janë ose siç parashikohen me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Juristi i Bashkisë duhet të ketë qenë në praktikë në profesionin e tij/të saj në Bashki për të paktën dy (katër) vjet para zgjedhjes

së tij/ të saj në pozicionin e Avokatit të Bashkisë.

NENI 79

DEPARTAMENTI URBAN

Fuksioni

Detyrat të Përgjithshme (*shëmbull*):

Departamenti Urban është kryesisht përgjegjes për:

- Planifikimit urban,
- Menaxhimin e tokës dhe strehimin,
- Shqyrtimin e aplikimeve për miratimin e shesheve dhe lejeve të ndërtimit,
- Kontrollin e punimeve të objekteve në ndërtim,
- Dhënien e lejes së shfrytëzimit ose banimit.

Ky departament ka për detyrë t'u bëjë rekomandime Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë si dhe njësisë të tjera organizative në Bashki mbi synimet dhe politikat urbane dhe mbi planet për zhvillimin e Bashkisë sipas nevojave të sotme dhe të ardhshme.

Ai përgatit materialet që do të shqyrtohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë. Drejtori i departamentit është njëkohësisht dhe Sekretar i Këshillit të Rregullimit të Territorit.

NENI 80

KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT (K.RR.T)

Fuksioni

Detyrat të Përgjithshme (*shëmbull*):

(Për specifikime për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësit shih Ligjin për Urbanistikën)

Këshilli i Rregullimit të Territorit përbëhet nga ____ anëtarë të cilët janë:

1. ____ Kryetari i Bashkisë Kryetar
2. ____ Anëtar

Afati i mandatit të K.Rr.T është nga data _____ 2004 deri _____ 2006.

NENI 81

DEPARTAMENTI I PERSONELIT

Fuksioni

Detyrat të Përgjithshme (*shëmbull*):

Departamenti i personelit është përgjegjës lidhur me mbarëvajtjen e procedurave uniforme për rekrutimin, përzgjedhjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një force pune efektive dhe të përgjegjshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në reklamat e punës, trainime, kategorizimin e punës, ekzaminime, transferime brenda sistemit, zhvillimit të karrierës, administrimit të pagave, marrëveshjeve të punës, sigurisë, përfitimit të nëpunësve, procedurat e ankesave, disiplina, shkarkimit, pezullimit dhe heqjes nga posti me votim, rregullimi i veprimtarisë politike, dhe çështje të tjera personale.

NENI 82

DEPARTAMENTI I TAKSAVE

Funksioni Kryesor: Të planifikojë, krijojë, organizojë dhe menaxhojë sitemet e regjistrimit të subjekteve dhe objekteve të taksueshme, të llogaritjes së detyrimit dhe të shpërndarjes së akt-detyrimeve taksapaguesve publik dhe privat brenda juridiksionit të Bashkisë.

Detyra të Përgjithshme:

- Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave mbi subjektet dhe objektet e taksave.
- Inspektime dhe kontrole për të përmirësuar cilësinë e bazës së të dhënave.
- Mbledhja dhe regjistrimi i të gjitha ndryshimeve të subjekteve dhe objekteve të taksueshme
- Përgatitja, prodhimi dhe dërgimi i akt-detyrimeve për taksat/tatimet;
- Përgatitja dhe prodhimi i listave të të gjitha taksave që do të mblidhen, të nënshkruara zyrtarisht nga Kryetari i Bashkisë dhe Shefi i Sektorit.
- Regjistrimi, hetimi dhe zgjidhja e ankesave të taksapaguesve.
- Realizon sekuestrimet dhe konfiskimet ndaj debitorëve.

NENI 83

DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Fuksioni

Detyrat të Përgjithshme (*shëmbull*):

Departamenti i punëve publike është kryesisht përgjegjës lidhur me:

- Mirëmbajtjen e objekteve publike nën administrimin e bashkisë,
- Mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve,
- Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra,
- Ndriçimin publik,
- Pastrimin e qytetit,
- Përpunimin e mbeturinave,
- Mirëmbajtjen e varrezave publike,
- Ujësullësin dhe ujërat e zeza,
- Transportin publik urban.

NENI 84

DEPARTAMENTI I POLICISË

Çdo rajoni të Bashkisë i sigurohet mbrojtja e duhur e policisë.

Departamenti i Policisë përbëhet nga një Shef Policie dhe nëpunësit dhe punëtorët e varësisë, numri i të cilëve përcaktohet me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Shefi i Policisë

- Emërohet nga Kryetari i Bashkisë. Ai ose ajo përzgjidhet nga Kryetari i Bashkisë mes tre kandidatëve të parë në një provim kandidimi që zhvillohet nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë. Të gjithë oficerët e varur të policisë caktohen nga Shefi i Policisë sipas rregullave dhe rregulloreve të shërbimit civil.
- Menaxhon Departamentin e Policisë dhe me qëllim drejtimin dhe kontrollin e tij, vendos rregullat dhe rregulloret, që janë në përputhje me ligjin; Shefi i Policisë i përgjigjet Kryetarit të Bashkisë për administrimin e Departamentit të Policisë dhe zbatimin e ligjit.
- Është ruajtësi kryesor i rendit në Bashki, dhe çdo masë, apo vendim për sekuestrim, pezullim, pagim dëmi, vendosje gjobe e marrë nga Bashkia i drejtohet ati/ asaj për ekzekutim, dhe mund të ekzekutohet nga Shefi i Policisë ose çdo ruajtës rendi.

NENI 85

DEPARTAMENTI I ZJARRFIKËSVE

Fuksioni

Detyrat të Përgjithshme (*shëmbull*):

Departamenti i zjarrfikësve duhet të ketë autoritetin dhe detyrën të kontrollojë dhe të shuajë zjarre të dëmshme dhe të rrezikshme, të eliminojë kur është e mundur shkakun e zjarrit ,si dhe të detyrojë zbatimin e të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore lidhur me parandalimin dhe përhapjen e zjarreve, si dhe me kontrollin dhe rrezikshmërinë e zjarreve në Bashkinë.

K A P I T U L L I V I I

Ç E S H T J E T F I N A N C I A R E D H E T E B U X H E T I T

NENI 86

ADMINISTRIMI I FINANCIVE TË BASHKISË

Financat dhe buxheti i Bashkisë menxhihen nga Drejtori i Financave.

Kryetari i Bashkisë mbikqyr zbatimin e politikave financiare dhe të buxhetit.

NENI 87

BUXHETI I BASHKISË

Buxheti i Bashkisë përfshin të gjitha të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet së bashku me pagesat e huasë.

Buxhetit ka si qëllim (Neni 19, pika 6, Ligjit Organik “Buxheti i Qeverisë Vendore),

- përdorimin me efektivitet i burimeve për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të Bashkisë;
- paraqitjen qartë të situatës financiare të Bashkisë;
- reflektimin finaciare të politikave të Bashkisë;
- dhënien e informacionit të nevojshëm, që u mundëson qytetarëve pjesëmarrjen në

vendimmarrje në lidhje me funksionet dhe kompetencat e ushtruara nga Bashkia.

Bashkia në buxhetin e saj duhet të bëjë parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse. (*Neni 19, pika 6, Ligjit Organik "Buxheti i Qeverisë Vendore*),

Bashkia miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet pa deficit dhe në përputhje me ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".

NENI 88

REVIZORI I BASHKISË

Revizori i Bashkisë shqyrton dhe verifikon saktësinë e llogarive dhe shënimeve të Bashkisë; inspekton marrjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e fondeve publike dhe kryen detyra të tjera të përshkruara me ligj apo vendim të Këshillit të Bashkisë. Revizori

NENI 89

FONDI REZERVË

Fondi Rezervë krijohet me vendim të Këshillit të Bashkisë. Ky fond përdoret për

të paguar punëtorët e Bashkisë mes ditëve të rregullta të pagesës dhe rimbursohet ditën tjetër që pason ditën e pagesës me transferimin aty nga fondet e para caktuara.

Sasia e fondit përcaktohet çdo vit me miratimin e buxhetit por nuk është më shumë se 3% të shpenzimeve totale vjetore.

Ky fond mund të përdoret për pagimin në raste emergjencash civile.

Ky fond mund të përdoret për pagimin e shpenzimeve për ngarkesa, postat e shpejta, telegramet, pakot dhe shpenzime të tjera të ngjashme të departamenteve të ndryshme.

Pagesat bëhen me vërtetim të Drejtorit të Financës.

Fondi i përdorur rimbursohet çdo muaj nga fondet e para caktuara.

(rekomandohet specifikime të tjera të bëhen në përputhje me ligjet)

NENI 90

HUATË E PËRKOSSHME

Këshilli i Bashkisë, pas vendosjes së taksave çdo vit, ka kompetencë të japë hua të përkohshme në avancë të mbledhjes së

këtyre taksave. Hua të tilla përdoren për qëllimet për të cilat taksat janë vendosur dhe jo për qëllime të tjera, dhe të tilla taksa aplikohen për të paguar këto hua.

NENI 91

DEKRETE QË KRIJOJNË BORXHE

Çdo borxh ose detyrim i çdo lloji ndaj Bashkisë krijohet vetëm me dekret të Këshillit të Bashkisë që specifikon shumën dhe objektin e një shpenzimi të tillë.

NENI 92

PARATË I PAGUHEN ARKËS SË BASHKISË

Çdo zyrtar ose agjent i Bashkisë ose person tjetër që merr ose ka në dorën e tij ose të saj para që i duhen paguar Bashkisë në çdo mënyrë, menjëherë ia paguan këtë shumë Arkës së Bashkisë. Çdokush që nuk paguan shumën e marrë për më shumë se dyzetetë orë, duke përjashtuar të dielat dhe ditët e pushimit, pasi paratë të merren prej tij ose prej saj, është përgjegjës para Bashkisë për dyfishin e shumës së marrë.

NENI 93

KONTROLLI I BRENDSHËM FINANCIAR

Për të ushtruar kontrollin e brendshëm financiar, Këshilli i Bashkisë krijon Komisionin e Financave, i cili vepron gjatë gjithë periudhës së mandatit të Këshillit.

1. Komisioni i Financave kontrollon të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organi ekzekutiv, në përputhje me buxhetin e miratuar nga Këshilli. Kryetari i Bashkisë i raporton Komisionit të Financave rregullisht gjatë vitit dhe i dorëzon atij dokumentacionin e kërkuar prej tij. Kryetari i Bashkisë dhe administrata e tij nuk mund të bëjnë pjesë në këtë Komision.
2. Komisioni i Financave kontrollon të gjithë dokumentacionin kontabël dhe financiar.
3. Komisioni ka të drejtë të kërkojë auditim të jashtëm të llogarive të kryer nga ekspertë kontabël të autorizuar.

NENI 94

KONTROLLI I JASHTËM FINANCIAR

Bashkia i vë në dispozicion të kontrollit të jashtëm financiar të Kontrollit të Lartë të Shtetit për ligjshmërinë e përdorimit të burimeve financiare, të gjithë dokumentat financiare. Të njëjtën gjë e bën edhe për kontrollin e ushtrura nga ana e organeve të pushtetit qendror, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

K A P I T U L L I V I I I

S I S T E M I I S H Ě R B I M I T C I V I L N Ě B A S H K I

NENI 95

Sistemi i shërbimit civil në Bashki krijohet me vendim Këshillit të Bashkisë dhe administrohet nga Drejtori i Personelit, që emërohet nga Kryetari i Bashkisë.

Vendimi, në zbatim të ligjit 8549 “Për Statusin e Nëpunësit Civil” përcakton procedura uniforme për rekrutimin, përzgjedhjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një force pune efektive dhe të përgjegjshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në reklamat e punës, trainime, kategorizimin e punës, ekzaminime, transferime brenda sistemit, zhvillimit të karrierës, administrimit të pagave, marrëveshjeve të punës, sigurisë, përfitimit të nëpunësve, procedurat e ankesave, disiplina, pezullimit dhe shkarkimit dhe heqjes nga puna.

NENI 96

Të gjithë nëpunësit e Bashkisë janë anëtarë të shërbimit civil përveç zyrtarëve të zgjedhur, si dhe punonjësve që mbajnë pozicione të cilat nuk përfshihen në shërbimin civil.

NENI 97

NIVELET E NËPUNËSI NË ADMINISTRATËN E BASHKISË

Administratës së Bashkisë përbëhet nga tre nivele nëpunësish:

- a. Politik - Jo Punonjës Civil.

Kryetari i Bashkisë

Z/Kryetari i Bashkisë

Sekretari i Këshillit të Bashkisë.

Nëpunësit e Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.

- b. Jo politik- Punonjës Civil

Drejtuesit e Njësive Organizative.

Drejtuesit e Agjensive në Varësi të Bashkisë.

Specialistët.

- c. Jo politik - Jo Punonjës Civil

Shoferë.

Sanitare.

NENI 98

MARRËVESHJET PËR PUNËN

E drejta e nëpunësve të Bashkisë për të kontraktuar kolektivisht, përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre, nuk

shfuqizohet nga Bashkia, por asnjë kontratë kolektive nuk hyn në fuqi pa u ratifikuar nga Këshilli i Bashkisë. Këshilli i Bashkisë nuk ratifikon kontrata që nuk janë në përputhje me ligjin, Kodin e Punës, Statusin e Nëpunësit Civil dhe këtë Statut.

NENI 99

PARIMET E MERITËS

Rekrutimi, përzgjedhja, transferimi dhe gradimi i nëpunësve bëhet në bazë të aftësisë, njohurive dhe dhuntive të tyre relative pavarësisht nga besimi ose aktiviteti politik. Proçesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes përfshin njoftimin për vendin e punës dhe një egzaminim të hapur të aplikantëve të kualifikuar për emërim fillestar;

Nëpunësve të Bashkisë i garantohet:

- Trainimi për të siguruar kryerje me cilësi të detyrave dhe për të inkurajuar gradimin e tyre;
- Ruajtja e tyre në bazë të aftësisë në kryerjen e punës;
- Trajtim i barabartë i kandidatëve dhe nëpunësve dhe respektim i jetës së tyre

private dhe të drejtave kushtetuese si qytetarë;

- Mbrojtje nga detyrimet ose ngacmimet për qëllime politike;
- Ndalimi i përdorimit të autoritetit të tyre zyrtar për të të ndërhyrë ose cenuar rezultatet e çdo zgjedhjeje ose emërimi në pozicion.

NENI 100

KOMISIONI I SHËRBIMIT CIVIL

Komision Shërbimi Civil është një komision i pavarur i përbërë nga tre anëtarë për të dëgjuar apelimet që përfshijnë administrimin e sistemit të shërbimit civil.

Komisioni mund t'i paraqesë Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë rekomandime në lidhje me sistemin e shërbimit civil siç e çmon të përshtatshme.

Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil shërbejnë në afate tre vjeçare.

Komisionit të Shërbimit Civil përbëhet nga tre (tre) anëtarë, një anëtar përzgjidhet nga Kryetari i Bashkisë, një nga Këshilli i Bashkisë dhe një anëtar zgjidhet nga nëpunësit e shërbimit civil; të gjithë

anëtarët hiqen vetëm për shkaqe të caktuara nga autoriteti i tyre përzgjedhës. Mënyra e zgjedhjes dhe heqjes së anëtarit që përfaqëson nëpunësit e shërbimit civil bëhet siç parashikohet nga akti përkatës i miratuar në Këshillin i Bashkisë.

Kur një anëtar i Komisionit është i paaftë për çdo lloj arsyeje të kryejë një nga detyrat e tij/saj në Komision, atëherë Komisioni mund të zgjedhë një anëtar të përkohshëm në një mënyrë të përcaktuar me akt.

NENI 101

NËPUNËS TË PAVARUR

Asnjë anëtar i Këshillit të Bashkisë nuk ka juridiksion të gjykojnë një konkurs për rekrutimin e kandidatëve që pretendojnë të punësohen në një pozicion në Bashki.

NENI 102

PROÇESI I APELIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Komisioni vendos rregulla për veprimtarinë e tij. Komisioni ka kompetencë të administrojë betimet, të nxjerrë letër-thirrje, të marrë provat përkatëse, të detyrojë prodhimin e dokumenteve, të pyesë dëshmitarë në seancat dëgjimore që zhvillon, dhe të nxjerrë urdhra zhdëmtues si

ti çmojë të arsyeshme. Në çdo apel që ka të bëjë me proces disiplinor, nëpunësi ka të drejtën të ripyesë dëshmitarin, dhe të kërkojë për praninë e dëshmitarëve dhe prodhimin e provave që lidhen me rrethanat në hetim. Në të gjitha rastet apeluesi ose zyrtari veprimi i të cilit paditet ka të drejtën e një seance dëgjimi publik dhe të përfaqësimit nga një person i zgjedhur prej tij ose prej saj.

Komisioni mund t'i delegojë njërit ose shumë shqyrtuesve të seancës dëgjimore kompetencat e veta, por një vendim i marrë nga shqyrtuesi në seancë dëgjimore mund të apelohej në Komision nga të dyja palët. Procedimet regjistrohen. Drejtori i Personelit dhe stafi i tij ose i saj, nuk mund të shërbejnë si shqyrtues në seancë ose staf i Komisionit.

Seancat dëgjimore zhvillohen sa më të volitshme në kohë dhe vendimet merren brenda tridhjetë ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore. Nëse Komisioni nuk arrin në një vendim brenda tridhjetë ditëve, përveç kur apeluesi jep pëlqim për një zgjatje afati, vendimi, nëse ka të tillë, i Shqyrtuesit të Seancës Dëgjimore mbetet në fuqi.

Askush nuk ka tagër të apelojë në Komisionin e Shërbimit Civil nëse çështja që apelohehet ka qenë paraprakisht objekt shqyrtimi i arbitrazhit detyrues sipas një kontrate pune.

NENI 103

PEZULLIMI OSE SHKARKIMI I PUNONJËSIT CIVIL

Asnjë anëtar i shërbimit civil nuk mund të pezullohet ose largohet nga detyra përveç se për shkaqe të përligjura. Një deklaratë me shkrim me arsytet për pezullim ose shkarkim i dorëzohet nëpunësit nga kreu i departamentit dhe depozitohet tek Komisioni i Shërbimit Civil. Çdo nëpunës që pezullohet ose largohet ka tagër të apelojë në Komision përveç sipas parashikimeve të nenit të mësipërm.

NENI 104

PUNËSIMI JASHTË BASHKISË I NËPUNËSVE TË BASHKISË

Nëpunësit e Bashkisë mund të angazhohen në punësim të ligjshëm jashtë në masën e lejuar nga ligji dhe ky Statut (*mund të specifikimet*).

K A P I T U L L I I X

A G J E N S I T Ë N Ë V A R Ë S I T Ë B A S H K I S Ë

NENI 105

Agjensitë në varësi të Bashkisë janë Institucionet dhe Ndërmarrjet të cilat kanë ushtrojnë veprimtarinë e tyre përputhje me ligjet specifike, Statutin e Bashkisë dhe vendimet e Këshllit të Bashkisë.

Ato kanë varësi financiare të plotë apo të pjesëshme nga buxheti I Bashkisë.

Ato kanë varësi administrative të plotë nga organet qeverisë të Bashkisë.

KREU 1 Institucionet në Varësi të Bashkisë

NENI 106

Institucionet në varësi të Bashkisë janë:

- Biblioteka
- Teatri Publik
- Galeria e Arteve

- Qendra e Kulturës
- Muzeumet Bashkiake
- Çerdhet dhe Kopshtet

(Jepen specifikimet për statusin dhe organizimin e secilit institucion)

NENI 107

BIBLIOTEKA E BASHKISË

Bashkia ka një Fond Biblioteke që përbëhet nga:

1. Fondi aktual i Biblotekës;
2. Dhurata: Dhurata, trashëgimi që mund të jepen, ose t'i trashëgohen Bashkisë ose çdo të besuari për përdorim ose qëllim të "Bibliotekës Publike së Bashkisë _____";
3. Qeratë: Qiratë dhe përfitimet që rrjedhin nga çdo pronë që mund të mbahet ose posedohet në besim për këtë bibliotekë nga Bashkia ose çdo i besuar tjetër.
4. Fondet finaciare që Këshilli Bashkiak mund t'i alokojë Bibliotekës.

NENI 108

TITULLI I PRONËSISË

Titulli i gjithë pronës që i përket Bibliotekës Publike të Bashkisë është dhe mbetet në emër të Bashkisë, dhe konsiderohet i paprekshëm për përdorim dhe përfitim nga kjo bibliotekë.

NENI 109

BORDI I BIBLIOTEKËS; EMËRIMI; AFATET

Bordi i Bibliotekës përbëhet nga pesë Administratorë të Bibliotekës që përbëjnë dhe njihen si trupi qeverisës i bibliotekës. Kryetari i Bashkisë, me pëlqimin e Këshillit Bashkiak, emëron pesë Administratorë, secili prej të cilëve mban postin për pesë vjet pa kompensim. Të emëruarit janë qytetarë që njihen për merita qytetare për këtë post.

NENI 110

BIBLIOTEKARI

Bibliotekari përzgjidhet dhe mund të hiqet nga Bordi. Ai/ajo mban cilësi të tilla që përputhen me postin sipas kërkesave të Bordit. Ai/ajo, me pëlqim të Bordit të Bibliotekës, emëron dhe shkarkon të gjithë nëpunësit e Bibliotekës.

NENI 111

MENAXHIMI I BIBLIOTEKËS; SHPENZIMET

Bordi i Bibliotekës menaxhon dhe kontrollon bibliotekën publike dhe ka kompetencë të zgjerojë Fondin Bibliotekar; Bordi verifikon shpenzimet e Drejtorit të Financës.

KREU 2 Ndërmarrjet në Varësi të Bashkisë

NENI 112

NDËRMARRJET NË VARËSI TË BASHKISË JANË:

Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizime

Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Rrugëve

Ndërmarrja e Pastrimit

Ndërmarrja e Gjelbërimit, Parqeve
Mjediseve Argëtuese

Ndërmarrja e Transportit Publik

Klubi i Futbollit

Klubi Shumë Sportesh

(Jepen specifikimet për për statusin dhe organizimin e secilës ndërmarrje)

NENI 113

BORDI I PARQEVE DHE MJEDISEVE ARGETUESE

Bordi i Parqeve dhe i Mjediseve Argetuese krijohet për të vepruar si këshilltar i Kryetarit dhe Këshillit të Bashkisë, Departamentit të Parqeve dhe Argëtimit dhe departamenteve të tjerë të Bashkisë në lidhje me çështje të parqeve dhe argëtimit. Numri i anëtarëve të këtij bordi, afati i punës dhe mënyra me të cilën emërohen dhe hiqen, detyrat e tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit.

K A P I T U L L I X

K U S H T E T P Ë R K O N T R A K T I M

NENI 114

DETYRAT E KONTRAKTIMIT

Përgjegjësia për bërjen e të gjitha kontratave për punë publike, shërbime, furnizime, materiale ose pajisje i caktohet Komisionit të Prokurimeve.

Këshilli i Bashkisë, në përputhje me ligjin nr. 7971 “Për Prokurimet Publike“, përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e këtij komisioni.

NENI 115

NJËSIA E PROKURIMEVE

Në ndihmë të Komisionit të Prokurimit, me vendim të Kyetarit të Bashkisë, ngrihet Njësia e Prokurimeve.

NENI 116

KUSHTET PËR KONTRAKTIM

Për kontratat e Bashkisë kërkohet si vijon:

- a. Të gjitha kontratat që përfshijnë më shumë se sa shuma që përcaktohet me urdhëresë bëhen me shkrim. Këto kontrata i jepen ofruesit më të lirë dhe të

mirë, pas njoftimeve publike siç mund të përshkruhet me urdhëresë.

- b. Çdokush që kontraktohet nga Bashkia për punë apo shërbime publike do të paguhet jo më pak se sa niveli ekzistues i pagës për nëpunësit e Bashkisë që kryejnë punë të ngjashme.

Të gjitha ofertat për prokurime me fodet e Bashkisë do të njoftohen publikisht në dy gazeta kombëtare, në gazetën vendore dhe në gazetën e Bashkisë (*për specifikime shih edhe ligjin Per Prokurimet Publike*“).

NENI 117

DËGJIMET PUBLIKE PËR LIDHJE KONTRATE.

Përpara se hyjë në marrëdhënie kontraktuale për mallra, shërbime apo ndërtime jashtë prokurimeve të hapura apo të drejtpërdrejta, të cilat kapin një vlerë më të madhe se 50 milion lekë, drejtuesi i agjensisë së prokurimit të Bashkisë duhet të organizojë një dëgjim publik një muaj para lidhjes së kontratës, dëgjim të cilin duhet ta njoftojë sipas rregullores së Bashkisë për organizimin e dëgjimeve publike.

K A P I T U L L I X I

Ç E S H T J E T E T J E R A

NENI 118

BETIMI PËR NËPUNËSIT E ZGJEDHUR APO TË EMËRUAR

Çdo person i zgjedhur apo nëpunës i Bashkisë, para marrjes së detyrave të pozicionit të tij/ saj, merr dhe nënshkruan një betim që ai/ ajo ka të gjitha cilësitë e përshkruara për punën e tij ose të saj, nga ky Statut, që ai ose ajo mbështet Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe Statutin dhe aktet e Bashkisë, që do të përmbushë besnikërisht dhe do t'i bindet të gjitha kërkesave të pozicionit të punës.

Nëse personi i zgjedhur ose i emëruar në një pozicion nuk merr ose nënshkruan betimin, pozicioni i tij konsiderohet bosh.

Teksti i betimit për të zgjedhurit është *(përshkruhet me fjalë)*.

Teksti i betimit për nëpunësit e emëruar është *(përshkruhet me fjalë)*.

Teksti i betimit për nëpunësit e emëruar miratohet dhe ndryshohet nga Këshilli Bashkiak me shumicë të thjeshtë votash.

NENI 119

KËRKESA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT KUNDËR BASHKISË

Të gjitha kërkesat për zhdëmtim dëmi kundër Bashkisë duhen depozituar tek Kryetari i Bashkisë brenda afatit të zbatueshëm të parashkrimit. Të gjitha kërkesat për zhdëmtim duhet të përcaktojnë dhe përshkruajnë me saktësi veprimin, mosveprimin ose cenin që shkaktoi lëndimin ose dëmin;

- të specifikojnë datën dhe vendin e humbjes së pretenduar;
- të përshkruajë bazën ku mbështetet përgjegjësia e Bashkisë, duke përfshirë çdo dëshmitar të njohur;
- të përshkruajë me saktësi lëndimin ose dëmin;
- të japin adresën e vendbanimit të kërkuarit për gjashtë muajt e fundit, të përmbajë pikat e dëmeve të pretenduara;

Asnjë padi ligjore në të cilën kërkohen dëme monetare nuk do të fillohet kundër Bashkisë derisa një kërkesë me shkrim për dëme të

paraqitet dhe depozitohet tek Kryetari i Bashkisë.

Nuk miratohet asnjë urdhëresë që pranon një kërkesë për dëmshpërblim ose një pjesë të saj, ose autorizon veprime që shërbejnë për të paguar ose kënaqur kërkesën ose pjesën e saj, derisa kjo e fundit t'i paraqitet departamentit të duhur, derisa ky departament të ketë bërë raportin e tij në Këshillin Bashkiak, në përputhje me këtë kërkesë.

Këshilli i Bashkisë mund të parashikojë, me një akt të përgjithshëm, një procedurë të ndryshme për paraqitjen dhe pagimin e çdo kërkesë për çdo shumë që mund të parashikohet herë pas here me akt të miratuar me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Bashkisë.

NENI 120

FLETORJA ZYRTARE E BASHKISË

Fletorja Zyrtare e Bashkisë publikon të gjitha procedurat zyrtare për të cilat ligji kërkon publikimin, e tyre. Një kopje e çdo fletoreje zyrtare të Bashkisë protokollohet dhe depozitohet pranë departamentit juridik të Bashkisë.

NENI 121

Të gjitha vendimet në fuqi në Bashki në datën e miratimit të këtij Statuti, dhe që nuk vijnë në kundërshtim me të, mbeten në fuqi deri sa të shfuqizohen ose të mbarojë afati i tyre.

NENI 122

RRUGËT PËRGJATË TOKAVE BREG DETARE, LIQENORE APO LUMORE (SHËMBULL)

Të gjitha rrugët, bulevardet, autostradat e tjera publike të përcaktuara më pare në këtë dokument, mbi ose përgjatë çdo toke baticash brenda Bashkisë, ose në ujërat e Liqenit, përrenjve ose rrjedha të tjera brenda Bashkisë, sipas Kushtetutës dhe ligjeve ose sipas çdo statuti ose dekreti të Bashkisë Siatëll, ose nga çdo autoritet tjetër i ligjshëm të përcaktuara si rrugë ose autostrada publike, deklarohen të jenë rrugë dhe autostrada publike të Bashkisë, dhe i nënshtohen autoritetit të Bashkisë për t'i kontrolluar, përmirësuar ose hequr nga përdorimi siç është parashikuar ose siç do të parashikohet për rrugë dhe autostrada të tjera brenda Bashkisë.

Këshilli Bashkiak me urdhëresë mund të zgjerojë, vendosë ose heqë nga përdorimi çdo

rrugë mbi ose përgjatë portit, brigjeve
detare, liqenore apo lumore në Bashki.

K A P I T U L L I X I I

D I S P O Z I T A K A L I M T A R E

NENI 123

Të gjithë zyrtarët e emëruar në post në castin e hyrjes në fuqi të këtij Statuti vazhdojnë të mbajnë dhe ushtrojnë detyrat e tyre përkatëse në përputhje me kushtet dhe dispozitat dhe detyrimet e këtij Statuti, derisa të emërohen dhe kualifikohen zëvendësit e tyre përkatës.

NENI 124

Zyrtarët e zgjedhur të Bashkisë me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, vazhdojnë të mbajnë postin për kohën e mbetur të afatit dhe derisa të bëhet kualifikimi i pasuesve të tyre.

NENI 125

LIBRAT DHE REGJISTRIMET; INSPEKTIMI; KOPJET E NJEHSUARA; TARIFAT

Të gjitha librat dhe regjistrimet e çdo njësie organizative janë të hapura për inspektim nga çdo qytetar në çdo kohë gjatë orëve të punës. Kopje ose ekstrakte nga këto libra ose regjistrime, të njehsuara siç duhet, i jepen nga zyrtari që i ka ato nën kujdes çdo personi që i kërkon, duke paguar, për

përdorim të Bashkisë, tarifa që përcaktohen me vendim të Këshillit të Bashkisë.

NENI 126

ZYRAT PUBLIKE TË HAPURA

Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, të gjitha zyrat publike të Bashkisë mbahen të hapura për punë në ditët dhe orët e caktuara me urdhëresë të Këshillit të Bashkisë.

NENI 127

Asnjë pozicion pune nuk krijohet, asnjë person nuk punësohet, asnjë nëpunës nuk merr rrogë ose shpërblim për shërbime të çdo lloji, nëse kjo nuk parashikohet ose autorizohet me ligj.

NENI 128

Përgjegjësia e nëpunësve për miratimin, lejimin ose pagimin e kërkesave të paautorizuara.

Nëpunësi që aprovon, lejon ose paguan çdo kërkesë të paautorizuar me ligj përgigjet para Bashkisë personalisht dhe financiarisht për shumën që Bashkia ka

paguar për këtë kërkesë në tejkalim të shumës që i detyrohet Bashkisë për këtë.

NENI 129

Amendamentet e Statutit

1. Statuti i Bashkisë mund të amendohet nga Këshiili i Bashkisë dhe nga populli i Bashkisë me referendum vendor.
2. Çdo amendament ose amendamente të këtij Statuti mund të propozohen në Këshillin Bashkiak, nga:
 - a. $\frac{1}{3}$ e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë,
 - b. Pesëmbëdhjetë (15) përqind e numrit të votuesve të regjistruar të Bashkisë që votuan në zgjedhjet e mëparshme për të zgjedhur Këshillin dhe Kryetarit të Bashkisë,
 - c. ose _____ (*shëmbull - dhjetë mijë*) zgjedhës.
3. Kur peticioni me firma origjinale depozitohet në Këshillin të Bashkisë, është detyrë e Sekretarit të Këshillit të verifikojë dhe shqyrtojë të gjitha nënshkrimet duke i krahasuar me listat e zgjedhëzve dhe i raporton Këshillit të

Bashkisë gjetjet mbi numrin e nënshkrimeve të vlefshme që ndodhen në këtë peticion.

4. Këshilli i Bashkisë pasi shqyrton peticionin me propozimin/met për amendamente të statutit i voton ato. Statuti i Bashkisë mund të amendohet vetëm nëse PRO amemndamenteve votojnë 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë.
5. Çdo amendament ose amendamente të këtij statuti mund t'i nënshtrohen referendumit vendor me kërkesën e popullit të Bashkisë ____ duke respektuar nenet x-y të këtij Statuti si dhe kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

NENI 130

VËRTETIMI I STATUTIT

Ne, të nënshkruarit anëtarë të Këshillit të Bashkisë së _____ të zgjedhur në zgjedhjet e përgjithshme bashkiake të mbajtura në këtë Bashki më ____ 2004, sipas dispozitave të Kushtetutës dhe Ligjit 8652 datë 31.7.200 i Republikës së Shqipërisë, vërtetojmë se dokumenti i statutit të lartpërmendur u

përgatit nga ne, u paraqitet dhe u miratua si Statuti i Bashkisë _____.

Shtojca 1.

Seri e Manualeve të Prodhuara nga KOMPAS

1. Organizimi dhe Struktura e Qeverisë Vendore në Shqipëri (përfshihet model i rregullores së Këshillit të Bashkisë)
2. Model Rregullore e Brendëshme e Bashkisë
3. Menaxhimi Taksave dhe Tarifave Vendore
4. Menaxhimi Modern i Burimeve Njerëzore
5. Planifikimi Urban i Bashkisë
6. Udhëzes për Unifikimin e Procedurave për Miratimin e Shesheve dhe Lejeve të Ndërtimit
7. Raste Juridike Bashkiake

Shtojca të Tjera

Shtojca __

Emblema e Bashkisë _____ (*me ngjyra*)

Shtojca __

Flamuri i Bashkisë _____ (*me ngjyra*)

Shtojca __

Harta Administrativo Territoriale e
Bashkisë _____ (*me ngjyra*)

Shtojca __

Harta Administrativo Territoriale e Njërive
Administrative të Bashkisë _____
(*me ngjyra*)